

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje të trupit gjykues prej gjyqtarës Raima Elezi, si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve Vjollca Buzhala e Luan Berishai, si anëtarë të trupit, me pjesëmarrjen e sekretarës juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarve Sh.B nga fshati ... , K. e ... dhe B.N nga .., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së dhe B.L nga ..., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së, duke vendosur sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.190/14 e datës 31.08.2015 dhe e ndryshuar në fjalën përfundimtare me datën 24.10.2017 pas mbajtjes së seancave të shqyrtimeve kryesore publike në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Ervehe Gashi, të akuzuarve Sh.B, mbrojtësit i tij av. E.G, B.N, mbrojtësit të tij av. S.M dhe të akuzuarit B.L , me datë 27.10.2017, publikisht mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**1. SH.B,** nga i ati E.. dhe e ëma F., e lindur ..., i lindur më ... në fshatin ... Komuna e ... ku edhe jeton, ka të kryer Fakultetin e kimisë, Master i shkencave organike, me profesion profesor i kimisë, drejtor i gjimnazit “...” në ..., i martuar babë i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ....

**2. B.N,** nga i ati Q.. dhe e ëma Xh., e lindur ..., i lindur më ... në fshatin ... Komuna e ..., jeton në rr.”...” pn ..., ka të kryer Fakultetin e shkencave natyrore kimi - biologji, profesor, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, babai i katër fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ....

**3. B.L,** me nofkën “B..” nga i ati R.. dhe e ëma L., e lindur ..., i lindur më ... në fshatin ... Komuna e ..., jeton në Lagjen ... rr. “...” pn, ..., ka të kryer Fakultetin e historisë, zëvendës drejtori i gjimnazit “...” në ..., i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar baba i katër fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ....

**Në bazë të nenit 363 par. 1 pik. 1.3 të KPP-së**

**LIROHEN NGA AKUZA**

**Të akuzuarit Sh.B dhe B.N**

Se prej datës 20.09.2013 deri më datën 05.10.2013, në cilësinë e personave zyrtarë, Sh.B, në cilësi të drejtorit të gjimnazit “...” në ... dhe sekretar e Këshillit drejtues të shkollës, B.N, në cilësi të kryetarit të Këshillit drejtues të shkollës , të autorizuar për të bërë përzgjedhjen e ofertuesit sipas ofertës të përsëritur me nr. protokolit 491 të datës 24. Shtator 2013, lidhur me përzgjedhjen e Agjencisë turistike për ekskursion të maurantëve, duke e shfrytëzuar detyrën zyrtare i tejkalojnë kompetencat e tyre me qëllim të shkaktimit të dëmit personit tjetër dhe seriozisht ia shkelin të drejtat atij personi, në atë mënyrë që të akuzuarit Sh.B dhe B.N tejkalojnë autorizimet e dhëna nga Drejtorisë për Kulturë dhe Arsim të Komunës së Prizrenit, me qëndrimin me nr. 628/13 të datës 23.09.2013, për përzgjedhjen e ofertuesve për ekskursion, duke përpiluar tekstin e përsëritjes së ofertës për ekskursionin e maurantëve të shkollës së mesme të lartë, gjimnazit “...” në ... dhe në pjesën e kushteve të kësaj oferte vendosin kushtet të cilat i përshtaten ofertuesit të Kompanisë turistike “...”, e në kundërshtim me udhëziminin Administrativ nr. 27/13 e cila përsëritje e ofertës shpallet në mjetet e informimit, nuk e njoftojnë Këshillin Drejtues të shkollës “...” me përmbajtjen e këtij qëndrimi, për mospërcjelljen e kushteve të parashikuara me nenin 11 të Udhëzimit Administrativ 27/2013 të datës 18.06.2013, kështu Këshilli Drejtues i shkollës përsëri duke mos ditur këtë fakt vepron në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ nr. 27/13, pikërisht nenin 12 dhe 13 dhe Akt Qëndrimin me nr. 628/13 të datës 23 shtator 2013, të Drejtorisë Komunale për Arsim të KK Prizren, ashtu që ofertuesin “...” e eliminojnë pa bazë ligjore nga konkurrenca për shkak të licencës të skaduar edhe pse kanë ditur se me Ligjin për Turizëm nr. 04L-176 janë shfuqizuar dispozitat e ligjit të vjetër dhe licencat ende nuk kishin filluar të jepeshin, me ç’rast shpallin fitues Kompaninë turistike “...” me vendimin nr. 564 të datës 03 tetor 2013, pa qenë operatori ekonomik më i favorshëm, të akuzuarit B.N dhe B.L e nënshkruajnë këtë vendim duke i shkaktuar dëme material ofertueseve “...” të përfaqësuar nga R.K dhe duke dëmtuar çdo maurantë pjesëmarrës i ekskursionit me nga 11 €, poashtu i akuzuari Sh.B me datën 05. Tetor 2013 e nënshkruar regjistrin për ekskursion edhe pse e kishte ngrirë pozitën e tij për shkak të zgjedhjeve lokale që nga data 03. Tetor 2013.

- Me këtë si bashkëkryesit do të kishin kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

### **I akuzuari B.L**

Në cilësi të zëvendës drejtorit të shkollës me datën 04.tetor 2013 e pranon ankesën e ushtruar nga NTT “...” dhe ankesën e ushtruar nga agjencia turistike “...” kundër vendimit të Drejtorisë për përzgjedhjen e ofertuesit dhe në cilësi të zëvendës drejtorit i cili ishte i autorizuar ti kryej të gjitha punët në fushë veprimin të drejtorit të shkollës nuk e përmbushë autorizimin e tij në atë mënyrë që nuk e procedon ankesën mëtej në Këshillin Drejtues të shkollës e as vet nuk vendos lidhur me këtë ankesë me ç raste shkelë rëndë të drejtat e të dëmtuarve kompanisë dhe “...”.

-Këso dore do të kishte kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së.

Sepse nuk ka prova se kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen.

Të dëmtuarit NTT “...” dhe Kompania “...” për realizimin e kërkesës pronësoresh juridike udhëzohen në kontestin e rregull civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate .

## Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP.nr.190/14 e datës 31.08.2015, kundër të akuzuarve Sh.B nga fshati ... Komuna e ..., B.N dhe B.L, të dytë nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Duke vendosur në bazë të aktvendimit PAKR.nr. 118/17 të datës 2017 të gjykatës së Apelit e Kosovës dhe vërejtjeve të dhënë në te është mbajtur shqyrtimi kryesor ku prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka ndryshuar aktakuzën me datën 24. tetor 2017 ashtu që të akuzuarit Sh.B dhe B.N është akuzuar për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me neni 31 të KP-së dhe B.L për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPP-së

Në fjalën përfundimtare ka shtuar se në këtë çështje penale janë marr në pyetje të dëmtuarit G.H dhe R.K, dëshmitarët N.Ç, F.G, E.K, H.K, J.H, N.V dhe janë administruar provat materiale sipas propozimit të aktakuzës dhe atë procesverbali i mbledhjes së Këshillit Drejtues të datës 27.08.2013, vendimi i Këshillit Drejtues të shkollës të datës së njëjtë, kërkesa e Drejtorisë së shkollës dhe Këshillit Drejtues të datës 08.09.2013 , ftesa për ofertë e Drejtorisë së shkollës nr 149 të datës 12.09,13, pëlqimi i DKA-së në Prizren me nr, 596/13 të datës 13.09.2013, procesverbali i mbledhjes të Këshillit të shkollës të datës 20.09.2013, procesverbali i komisionit për vlerësimin e ofertave për realizimin e ekskursionit e nënshkruar nga i akuzuari Sh.B , vendimi i Këshillit Drejtues të shkollës data 20.09.2013 për përzgjedhje e kompanisë "...", vendimi i datës 23.09.2013 për përzgjedhje e Agjencisë të nënshkruar nga Sh.B dhe J.H, qëndrimi i DKA nr. 628 /13 dhe provat tjera si dhe deklaratat e të akuzuarve, në bazë të cilave është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin.

Nuk është kontestuese fakti se në rastin konkret është bërë përsëritja e ofertës për ekskursion e maturanëve të Shkollës së Mesme të Lartë- Gjinnazi "... " në ... nga ana e drejtorisë së shkollës "... " se këta kanë pasur një autorizim të tillë shihet nga pëlqimit i DKA-së në Prizren me nr. 596/16, vendimi i DKA-së për anulim, qëndrimi i DKA-së në Prizren nr. 628/13 të datës 23.09.2013, vendimi i DKA-së të datës 24.09.2013 për anulimin e të gjitha ftesave për ofertë , e-mail-i i drejtorit të DKA-së të datës 24.09.2013 dhe deklarata e drejtorit të DKA-së e dhënë në Prokurori dhe në gjykatë së bashku me vendimin e drejtorit të DKA-së me nr. 666/13 të datës 01.10.2013 për delegimin e kompetencave. Nga shpallja për përsëritjen e ofertës me nr. 491 të datës 24.09.2013 e pikërisht nga paragrafi kushtet, nga Drejtoria e shkollës, pra drejtori dhe kryetari i Këshillit Drejtues shihet se kanë kërkuar edhe kushtet e veçanta të cilat nuk janë të paraparë në UA nr.27/13 dhe me vendosjen e këtyre kushteve kanë favorizuar një kompaninë "...", nga procesverbali i mbledhjes së KD i shkollës të mbajtur me datën 03.10.2013, është vërtetuar se "... " është shpallë fituese si kompani ofertuese me 90 pika ndaj kompanisë "... " me 68 pika dhe "... " është eliminuar si kompani me licencë të skaduar.----- Nga procesverbali i njëjtë është vërtetuar se pjesëtarët e komisionit për vërtetimin e rezervimit të hotelit në Shëngjin kanë qenë të akuzuarit B.N dhe Sh.B, të cilit kanë shkruar për të bërë një vërtetim të tillë ndërsa vërtetimin për realizimin e ekskursionit të maturanëve të datës 06 tetor 2013, kanë nënshkruar të akuzuarit B.L dhe B.N. Nga regjistri i nxënësve maturan i datës 05 tetor 2013 rezulton se i akuzuari Sh.B me datën 05 tetor 2013 e ka nënshkruar si përgjegjës këtë dokument edhe pse e ka pezulluar pozitën e tij si drejtor. Është vërtetuar se gjatë hapjes së ofertave për herë të dytë janë bërë parregullsi në gjinnazin "... " ngase në ofertën e dytë drejtoria e shkollës ka kërkuar kushtet të cilat nuk parashihen me Udhëzimin Administrativ duke e ngarkuar Këshillin Drejtues të shkollës se gjoja ajo ka marrë vendim për kushte shtesë dhe me kërkesën e kushteve shtesë i ka dhënë

favore një operatorit duke mos i bërë të barabartë të gjithë, e po ashtu kjo ofertë ka pasur kufizim në datë, në vendim ku do të shkohet dhe kushtet e parapëlqyera e të cilat janë në kundërshtim me UD dhe pëlqimi për shkuarjen në ekskursion sipas kësaj oferte është lidhur kur drejtorit Sh.B zyrtarisht i është pezulluar puna për shkak të pjesëmarrjes në kampanjën zgjedhore. Përveç kësaj DKA nuk ka pranuar asnjë ankesë zyrtarisht nga gjimnazi sepse të gjitha gjërat janë bërë shpejtë e shpejtë para se të arrihet data kur drejtori me kompaninë kanë planifikuar të shkojnë në shëtitje dhe raporti i Këshillit të shkollës i është dorëzuar dëshmitarit pasi që ka përfunduar ekskursionin edhe pse kanë pasur për obligim ta dorëzojë menjëherë pas hapjes së ofertave. Në atë drejtim është karakteristike mbrojtja e të pandehurit B.L i cili ka deklaruar se prej datës 03 tetor 2013 ka marrë rolin e ushtruesit të drejtorit nga se drejtori e ka ngrirë pozitën e tij për shkak të pjesëmarrjes në fushat elektorale dhe atë ditë e ka nënshkruar dokumentin apo vendimin lidhur me përzgjedhjen e ofertës për ekskursionin e maturanëve për vitin 2013. Mbledhja është mbajtur në ora 19:00 kur unanimisht është zgjedhur kompania “...” dhe kështu për shkak të rrethanave të krijuara ai e ka nënshkruar vendimin ngase ekskursionin ishte caktuar për datën 06 tetor 2013, se nuk ka pasur njohuri që Këshilli i shkollës vendimin përfundimtar duhet të nënshkruaj pas shqyrtimit të ankesave eventuale të kompanive jo fituese dhe për këtë arsye e ka nënshkruar vendimin atë ditë. Me datën 04 tetor 2013 rreth orës 18:00 ka pranuar dy zarfe me dokumente nga dy kompani, këto dokumente i ka pranuar dhe i ka nënshkruar, ka qenë i vetëdijshëm se ankesat duhet të pranohen 3 ditë duke llogaritur edhe ditën e punës, por dita e tretë i binte e premtë dhe atë ditë në mëngjes nxënësit veç duhej të niseshin për në Shqipëri, pra nuk e ka mbledhur Këshillin Drejtues për vendosje pasi që çdo gjë ishte kryer dhe nxënësit ishin nisur në Shqipëri. Të akuzuarit Sh.B dhe B.N kanë deklaruar se gjatë përzgjedhjes së operatorit si kusht ka qenë përzgjedhja e operatorit ekonomikisht më të favorshëm por nuk janë përfillur procedurat e ofertës me rastin e përzgjedhjes së ofertuesit sipas kushteve të kërkuara me ftesën për përsëritjen e ofertës të datës 24.09.2013, për faktin se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontakte nuk figurojnë kriteret e specifikuar të peshuar ma përqindje përkatëse, nuk është përfillur neni 52 par. 2 dhe 3 të LPP. Oferta më e përshtatshme ekonomike kërkon deklarinimin e kriterëve me përqindje, specifikimin dhe peshimin e të cilit kriter në përqindje për llogaritjen e gjetjes e ofertës më të përshtatshëm ekonomik. Neni 11 pik. 2.13 UA përcakton kushtet që duhet plotësuar për përzgjedhjen e Agjencisë turistike sipas ofertës , pra të jetë i licencuar, të ketë bërë kontrollin teknik sipas procedurave ligjore dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve, autobusi të jetë komfortë dhe me klimë, të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit, të figurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi që mjeku i shoqëron nxënësit, mirëpo askund në këtë dispozitë ligjore e as në Udhëzimin Administrativ nuk kërkohen kushtet të cilat janë përcaktuar në riefertë si kushte të veçanta dhe me këtë janë shkelur të drejtat e personave të tretë, këtu të dëmtuarve. Në ligjin për turizëm 04/L-176 nuk përcaktohet që Agjencia turistike duhet të ketë licence dhe neni 22 i këtij Ligji shfuqizon ligjin e mëparshëm për turizëm dhe shërbime turistike. Tejkalmimi i autorizimeve të pandehurve Sh.B dhe B.N konsiston në faktin se gjatë përpilimit të tekstit për përsëritjen e ofertës për ekskursionin e maturanëve të SHML “...” në Prizren, si drejtor e shkollës vendosin kushtet të cilat i përshtaten ofertuesit të kompanisë turistike “...” edhe pse kanë qenë të obliguar që kushtet ti përcaktojnë në bazë të udhëzimit UA dhe Ligjit të Prokurimit Publik dhe i tejkalojnë kompetencat të cilat u ka dhanë DKA-ja me qëndrimin nr. 628/13 të datës 23.shtator 2013, ndërsa të pandehurit B.L dhe B.N i tejkalojnë autorizimet e tyre duke nënshkruar vendimin nr. 564 të datës 03.tetor. 2013, pa kaluar afati i ankesave dhe pa u shqyrtuar at, ndërsa i pandehuri B.L nuk i ka përmbushur detyrat e tij sipas autorizimit për procedimin e ankesave mëtejme në Këshillin Drejtues të kësaj shkolle dhe me këtë kanë shkaktuar dëme materiale personave të tretë- çdo nxënësi nga 11 € ndërsa të dëmtuarave Agjencive turistike kanë shkaktuar dëme material në vlerën e shpenzimeve të bëra.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.B, av. E.G në fjalën përfundimtare ka theksuar se me provat e administruara nuk është vërtetuar se në veprimet ose mosveprimet e të mbrojturit të tij formohen elementet qenësore të veprës penale për të cilën akuzohet, nuk mund të mohohen të dhënat se Sh.B nuk ka qenë drejtor i Shkollës së mesme- gjimnazit “...” në ..., por absolutisht nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 par. 1 dhe par. 2.13 të UA sepse në asnjë mënyrë nuk e kanë favorizuar Kompaninë turistike “...” . I mbrojturi i tij qartë ka shpjeguar procedurën dhe rrjedhjen e saj gjer tek përzgjedhja e kësaj kompanie si kompani më e favorshme me vota unanime nga Këshilli Drejtues duke u bazuar në vendimin e DKA për delegimin e kompetencave. Në atë drejtim ka dëshmuar edhe Drejtori i DKA N.Çsi dhe kryetari i Këshillit Drejtues B.N. Detyra e mbrojturit të tij përderisa ka pasur kompetencë të drejtorit, ka qenë sekretar i Këshillit Drejtues, pa të drejtë vote i cili ka përpiluar procesverbalin, ka udhëzuar Këshillin Drejtues të shkollës dhe asgjë më tepër sepse me ngrirjen e pozitës e tij të drejtorit për shkak të zgjedhjeve lokale nga data 03 tetor 2013, ndaj të njëjtit pushojnë të gjitha obligimet dhe të drejtat pranë shkollës ka qenë drejtor. Këshilli i shkollës bazuar në vendimin mbi bartjen e kompetencave, në UA, statutin dhe rregulloren e shkollës, ka bërë në fillim shpalljen e ofertave në gazetën zyrtare, ka njoftuar për ditën e hapjes së ofertave, ka vlerësuar kriteret e parapara në oferta dhe ka përzgjedhur ofertuesin më të favorshëm ekonomik, çka është vërtetuar nga vet i akuzuari dhe nga provat tjera, e në anën tjetër në aktakuzë thuhet se janë dëmtuar nxënësit por përkundrazi nxënësit nuk janë ankuar, prandaj konsideron se në veprimet e të mbrojturit tij nuk ekzistojnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohet dhe propozon si në bazë të neni 364 par. 1 pik. 1.3 të KPP-së të lirohet nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.N av. S.M në fjalën përfundimtare ka theksuar se i mbrojturi i tij ngarkohet me veprën penale nga neni 422 par. 1 dhe neni 31 të KP-së dhe në dispozitiv të aktakuzës përveç tjerash theksohet se i njëjti në cilësi të kryetarit të Këshillit Drejtues të shkollës “...” në ..., si i autorizuar për të bërë përzgjedhjen e ofertuesit respektivisht Agjencisë turistike për ekskursionin e maturanëve, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare i tejkalon kompetencat me qëllim të shkakimit të dëmit në rastin konkret kompanive “...” dhe “...” . Për të ekzistuar kjo vepër penale duhet që dikush të shfrytëzë detyrën zyrtare apo t’i tejkalojë kompetencat duke shkelur ligjin, e në rastin konkret asnjë ligj nuk është shkelur e po ashtu duhet të ekzistojë edhe dëmi material, por në këtë rast nuk është shkakuar dëmi material ndaj kompanive të përmendura, nuk ka përfitim material për vete apo për tjerët. Në intervalin kohor për të cilën akuzohet B.N, ai ka qenë kryetari i Këshillit Drejtues të Gjimnazit ku si anëtarë të Këshillit kanë qenë nëntë anëtarë edhe atë tre përfaqësues të prindërve, dy përfaqësues nga shoqëria palët me interes bizneset të emëruar nga Komuna, tre përfaqësues të mësimdhënësve dhe një përfaqësues i nxënësve, të gjithë këta anëtarë kanë të drejtë nga një votë sikurse edhe kryetari i Këshillit Drejtues. Lidhur me ligjshmërinë e punës së Këshilli, sipas UA nr. 27/2013 përgjegjës është drejtori i shkollës, në nenin 11 të tij parashihen detyrat dhe kompetencat e Këshillit Drejtues të shkollës edhe atë hartimi i rregullave të shkollës, puna e ngushtë me kompanitë dhe partnerë të tjerë në tregun e punës, vendosja për shfrytëzimin e fondeve që janë dhënë shkollës si kontribut nga prindërit ose donatorët e tjerë. Kryetari i Këshillit Drejtues e ushtron funksionin vullnetarisht, pa pagesë si përfaqësuesi i prindërve dhe si Organ kolektiv i cili përfaqëson interesat e nxënësve. Përkritazi me tenderin në fjalë për shkuarjen e nxënësve në ekskursion kompetenca për hapjen e tenderit ka qenë e DKA -së në Prizren, në rastin konkret e njëjta ka shpallë tenderin dhe me datën 24.09.2013, i ka anuluar të gjitha ofertat për realizimin e institucionit për shkollat e mesme të Komunës së Prizrenit dhe me datën 24.09.2013, me vendim me të cilin anulohet kërkesa për oferta e shpallur me datën 13.09.2013, në gazetën ditore “...”, pastaj DKA-ja me vendimin e datës 01.10.2013, i delegon kompetencat për zgjedhjen e Agjencisë turistike me të cilin

vendim autorizohet drejtori i shkollës dhe Këshilli Drejtues që të bëjnë përzgjedhjen. Në këtë drejtim drejtori në bashkëpunim me Këshillin Drejtues shpallin ofertën për realizimin e ekskursionit në fjalë në të cilën marrin pjesë tre ofertues edhe atë "...", "...", dhe "...", me ç raste formohet komisioni për vlerësimin e ofertave në përbërje nga Këshilli Drejtues dhe zëvendës drejtori të cilët e zgjedhin ofertuesin më të ngushtë "...", dhe "...", me ç raste vendosin që "...", të fitojë të drejtën për realizimin e ekskursionit të maturanëve me datën 06.10.2013, ndërsa Agjencia "...", nuk përzgjidhet ngase nuk i ka plotësuar kushtet e tenderimit, përveç tjerash nuk ka pasur leje nga Ministria e transportit për të pasur të drejtë qarkullimi me autobusë jashtë vendit. Lidhur me përzgjedhjen e ofertuesit më të mirë Këshilli Drejtues ka formuar një komision në përbërje prej kryetarit të Këshillit Drejtues, drejtorit të shkollës në cilësinë e sekretarit të Këshillit Drejtues dhe një përfaqësues i nxënësve dhe pas analizimeve të bëra, shkuarjes në Shqipëri – vizitës në hotelin "...", në Shëngjin, shikimit të kushteve të hotelit rreth akomodimit të nxënësve, vlerësimin të gjendjes teknike të autobusëve dhe vlerësimin të të gjitha kushteve tjera si dhe çmimit, kanë ardhur në përfundim që si ofertues të shpallet Agjensionin "...". Konsideron se në anën e të mbrojturit të tij nuk ekziston dashja apo ndonjë përfitim dhe dëmtimi i dikujt kur i tërë qëllimi i tij dhe Këshillit Drejtues si organ kolektiv ka qenë që ekskursioni në fjalë të realizohet sa më mirë dhe të mos të ketë kurrfarë problemi me rastin e shkuarjes të nxënësve në ekskursion, duke patur parasysh përvojat e hidhura të ekskursioneve, në këtë rast primare dhe esenciale ka qenë interesi i nxënësve dhe asnjë interes tjetër meqë askush nuk ka pësuar dëm moral apo material e as nuk është thyer Ligji në asnjë momente, andaj konsideron se nuk ekzistojnë elementet e veprës penale dhe propozon që gjykata të marrë aktgjykim lirues.

I akuzuari B.L në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në mbrojtjen e vet të dhënë pranë Prokurorisë dhe gjatë intervistimit në polici ka deklaruar se në momentin e marrjes së detyrës së drejtorit, po të kishte qenë jurist nuk do të kishte shfletuar aq shpejtë një tender dhe ad-hoc nënshkruar sepse detyrën ka pranuar në ora 17:00 ndërsa në ora 19:00 është mbajtur mbledhja e Këshillit të shkollës ku pas asaj mbledhje e ka nënshkruar vendimin e kompanisë fituese. Cilado kompani fituese që do të kishte fituar ai do të kishte nënshkruar për shkak të rrethanave të cilat i ka përmendur gjatë dhënies së mbrojtjes.

I akuzuari Sh.B në mbrojtjen e vet ka theksuar se Këshilli Drejtues i shkollës është njoftuar me qëndrimin e DKA-së për anulimin e ofertës, është munduar ta respektojë qëndrimin e DKA edhe pse qëndrimi si akti juridik nuk ka fuqi juridik, e por për shkak të raporteve hierarkike dhe marrëdhënieve që nuk i kanë pasur të mira me drejtorin e DKA-së është munduar të respektojë këtë . Sa i përket raporteve jo të mira me DKA-në sqaroi se edhe për kundër faktit se gjatë përzgjedhjes së ofertuesit sipas shpalljes së parë , me dy vota pro është zgjedhur ofertuesi "...", si ofertues më i favorshëm ekonomik. Drejtori i DKA-së ka qenë kundër dhe për këtë arsye edhe me qëndrimin e lartë cekur ka anuluar procedurën sipas ofertës së parë nga se ka konsideruar se përfaqësuesi i Këshillit Drejtues nuk ka autorizim nga kryesuesi i Këshillit Drejtues të shkollës për të përfaqësuar shkollën në këtë procedurë të ofertës dhe për këtë arsye ka respektuar qëndrimin e DKA-së dhe ka bërë rishpalljen e ofertës, kushtet kanë qenë ato të cilat kanë qenë paraparë në shpalljen e Këshillit Drejtues për ofertuesit dhe është futur edhe rezervimi i hotelit ngase sipas UA të Ministrisë ekskursioni i maturanëve është dashur të kryhet në periudhën kohore shtator – tetor, kështu që ka qenë koha shumë e shkurtër, andaj kjo ka qenë arsyeja dhe nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për të respektuar afatet kohore. Gjatë përcaktimit të kushteve janë munduar në maksimum t'i mbrojnë interesat e nxënësve. Më vonë ka kuptuar se ofertuesit të cilit nuk kanë fituar ofertën kanë bërë ankesa, por me datën 03.10.2013, është bashkangjitur kampanjës zgjedhore për zgjedhje lokale dhe sipas ligjit ka pezulluar pozitën si drejtor për periudhën kohore sa ka zgjatur kampanja, andaj nuk ka pasur të drejtë të japë ndonjë përgjigje ose të marrë vendim,

këtë është dashur të bëjë zëvendësi i drejtorit dhe Këshilli Drejtues i shkollës. Drejtoria e shkollës është institucion që menaxhon procesin edukativo arsimor i përbërë prej drejtorit dhe zëvendës drejtorit ndërsa Këshilli Drejtues është organi më i lartë i shkollës dhe e ka funksionin e Bordit. Me shpenzime personale dhe me automjetet personal kanë shkuar në vizitë për të verifikuar se në hotele a janë bërë rezervime nga ana e Agjencive turistike. Shton se të gjitha procedurat sipas UA dhe akteve ligjore janë respektuar dhe qëllimi i përbashkët i Këshilli Drejtues dhe i tij si drejtor, ka qenë që fëmijët të shkojnë rehat në ekskursion dhe të kenë kushtet e mira të akomodimit, ushqimit dhe kujdesit mjekësor. Ekziston procesverbali i Këshillit Drejtues të shkollës në të cilin është caktuar si anëtar i komisionit për verifikimin e rezervimit së bashku me B.N dhe A.H, nxënës dhe është caktuar në komisioni bashkë me N.V për përpilimin e listës së nxënësve maturantë të cilët shkojnë në ekskursion dhe gjatë përpilimit të asaj liste është bërë një lëshim teknik i datës ku definohet si datë 05 tetor e në fakt i kujtohet që data është dashur të jetë 18 tetor, për të bërë pagesat Kompanisë turistike “...” dhe nuk e konteston nënshkrimin e tij por konteston titullin ushtrues të detyrës sepse ka qenë vetëm anëtar i barabartë i komisionit si pjesë i kolektivit. Anulimi i ofertës së parë nga DKA është bërë për të gjitha shkollat të mesme dhe larta dhe për shkollën “...” ku ka punuar si ushtrues i detyrës në atë kohë të drejtorit . Sipas UA 27/2013 në përzgjedhjen e kompanisë fituese merr pjesë komisioni i përbërë prej tre anëtarëve edhe atë drejtori i shkollës, kryetari i Këshillit Drejtues ose një përfaqësuesi i Këshillit Drejtues të shkollës dhe drejtori i DKA-së. DKA ka pretenduar të shkarkohet nga përgjegjësia për këtë proces duke nxjerrë një qëndrim fillimisht që të anulohet oferta e parë me arsyetim se anëtar i Këshillit Drejtues nuk ka pasur autorizim nga kryetari i Këshillit Drejtues dhe se nuk parashihet me ligj dhe arsyeja e dytë ishte që të gjitha shkollat i kanë autorizuar Këshillat Drejtues të shkollave që të merren me procedimin e organizimit të ekskursionit të maturantëve. Si drejtor i shkollës është dashur të mbledh Këshillin Drejtues të shkollës për të njoftuar me qëndrimin e DKA-së për anulimin e ofertës së parë dhe rishpalljen e ofertës së dytë për caktimin e kriterëve të ofertës, kanë qenë të gjithë prezentë nga Këshilli Drejtues por nuk i kujtohet a ka qenë B.N. Gjithashtu janë konsultuar edhe me nëpunësinë e Zyrës së Prokurimit pranë Kuvendit Komunal, por nuk i kujtohet kush ka konstatuar, ai personalisht jo, se a do të ishte jo ligjore që të parashtrinë edhe kriterë tjerë që nuk janë paraparë në UA pasi që UA nuk parashihet kriterë konkrete për kushtet e ofertës dhe duke parashtruar ankesat e tilla në drejtorinë e të gjitha shkollave të mesme, është ndryshuar UA dhe kompetenca i jepet Këshillit Drejtues për të dhënë kriterë të tjerë. Kushtet dhe kriteret që janë parashtruar nga Këshilli Drejtues i shkollës kanë qenë publike, janë shpallë në gazetën ditore dhe çdo kompani ka pas të drejtë të konkurrojë dhe ofertojë për këtë ekskursion . Sa i përket kompetencave në Këshillin Drejtues të shkollës drejtori i shkollës është sekretari i Këshillit Drejtues pa të drejtë vote dhe në nenin 17 të Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovë, janë paraparë detyrat dhe obligimet e drejtorit të shkollës në Këshillin Drejtues. Nuk ka ndikuar në asnjë mënyrë tek anëtarët e Këshillit Drejtues të shkollës sepse ligjërisht është i thirrur që në funksionin të cilën e ka të mbrojt ligjshmërinë e Këshillit Drejtues, ka qenë pranishëm në takim, anëtarët e Këshillit Drejtues kanë ftuar ofertuesit për të hapur ofertat në praninë e tyre, pastaj ofertuesit janë nxjerr jashtë dhe të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues i kanë verifikuar dokumentacionet e ofertuesëve dhe në fund kanë marrë qëndrim që dy anëtarë të Këshillit Drejtues B.N në cilësinë e kryetarit të KDSH, A.H në cilësinë e nxënës, i kanë caktuar që të shkojnë në Shëngjin për të verifikuar dhe vërtetuar cilët nga kompanitë me të vërtet e kanë bërë rezervimin. Me datën 03.tetor kur është vendosur për kompaninë fituese nuk ka qenë i pranishëm ngase i është ngrirë pozita e drejtorit. Me donacione dhe para tjera jopublike menaxhon Këshilli Drejtues i shkollës, ndërsa me aktivitetet jashtë kurikulës nënkuptohen aktivitetet jashtë programit të përcaktuar nga MASHT, e kjo nënkupton se në këto aktivitete hyjnë shëtitjet, vizitat, pikniqet, organizimet e tribunëve jashtë programit të shkollës, organizimet e ekspozitave të ndryshme dhe ekskursionet . Pasi ekskursionet janë aktivitetet m

kohë më të gjatë, deri në 5 ditë dhe organizohet jashtë Republikës së Kosovës, procedurat janë të ndryshme nga aktivitetet tjera dhe mendon se për parat të cilat japin prindërit për fëmijët e tyre janë pajtuar me nënshkrimin që ka dhanë për organizimin e ekskursionit, prandaj parat e ekskursionit nuk konsiderohen donacion. Gjatë vizitës në Shëngjin kanë konstatuar që e vetmja kompani që kishte të rezervuar hotelin për datën prej 06 tetor deri më 10 tetor ishte kompania "...". Ekskursioni i maturanëve ka filluar prej vitit 2002 – 2003, çdo kompani turistike që ka ofertuar ka ofruar vende falas për nxënësit me gjendje të dobët ekonomike dhe një praktikë të tillë e kanë ndjekur deri më sot, mendon se është çështja humane por gjithmonë është parashikuar edhe në UA që për nxënësit me gjendje të dobët ekonomik, me që shkolla nuk ka buxhet të veçantë, të mundësohen shkuarja nga kompanitë që ofertojnë.

I akuzuari B.N në mbrojtjen e vet ka theksuar se nuk është profesor i gjimnazit "...", është prindi i dy nxënësve të asaj shkolle dhe është përzgjedhur si kryetar i Këshillit të prindërve e asaj shkolle "...", ka pasur njohuri se për shkak të mosrespektimit të afatit kohor është anuluar përzgjedhja e parë e pas kësaj është dhënë oferta për tenderim të ri dhe ka fituar ofertuesi "...", sipas Këshillit Drejtues të shkollës operatori "...", ka pas ofertën më të volitshme sepse këtë vit edhe një fëmija i tij ka shkuar në ekskursion dhe ai si prind ka qenë i interesuar për të gjithë nxënësit e shkollës të shkojnë komod dhe prandaj ka paguar prej xhepit shpenzimet e rrugës si anëtar i komisionit dhe së bashku me kryetarin e nxënësve kanë shkuar deri në Shëngjin për të verifikuar kushtet e akomodimit dhe të ushqimit dhe verifikimin e rezervimit nga ofertuesi. Gjatë përzgjedhjes së operatorit askush nuk ka ndikuar në vendim, por pasi që u kanë pëlqyer kushtet dhe shpenzimet kanë qenë më të vogla, edhe ai ka dhanë pëlqimin për "...". Vendimi ka qenë unanim. Gjatë vlerësimit personalisht ka pasur parasysh shumë probleme të mëhershme dhe për të ka qenë më me rëndësi që autobusët të jenë teknikisht në rregull, akomodimi të jetë më i mirë, operatorët të janë të pajisur me të gjitha dokumentet për udhëtim jashtë vendit dhe kushtet e akomodimit në hotel, ushqimi të jetë në nivel të duhur ngase më herët kanë pasur aksidente komunikacioni, kanë mbetur nxënësit në kufi me orë të tëra, ka pas helmime të nxënësve nëpër hotele të Shqipërisë, prandaj këto faktorë kanë qenë shumë të rëndësishëm dhe kanë qenë arsye për vendimin lidhur me operatorin "...". Nuk ka pasur qasje në përpilimin e listave të nxënësve të cilat kanë pasur të shkojnë pa pagesë ose të bëjë pagesën më të ulëta. Këshilli Drejtues i shkollës asnjëherë nuk ka punë me para publike apo individuale, nëse mblidhen nga nxënësit ose prindërit Këshilli Drejtues është një Kuvend i shkollës që miraton ose aprovon strategjitë e drejtorit të shkollës, nëse vjen ndonjë kërkesë nga fëmijët ose nga prindërit për diç të mirë për mbarëvajtjen e procesit mësimorë në shkollë. Në bazë të UA për tender është vendosur në DKA ku përveç përfaqësuesit të DKA-së është i thirrur edhe drejtori i shkollës dhe një anëtar i Këshillit Drejtues të shkollës. Në këtë UA, në nenin 11 pik. 1 dhe 2 përcaktohet saktë se kush e kontrollon ligjërisht punën e Këshillit Drejtues të shkollës. Në momentin e konkurrimit kompania "...", nuk ka poseduar dokumentin për të drejtën e daljes jashtë shtetit, kjo kompani ka hyrë në rrethin e ngushtë nëse i kujtohet aty për aty është vendosur pasi që kanë vlerësuar në fillim vetëm çmimet më të volitshme, por më vonë kanë kontrolluar dokumentacionin dhe kanë konstatuar që i mungon ai dokument. Këshilli Drejtues së pari ka qenë i obliguar që të kontrollon dokumentet për të bërë selektimin në tre më të volitshëm, në këtë rast Këshilli Drejtues ka marrë vendim që në rrethin e ngushtë të hyjnë tre operatorë, edhe pse "...", nuk ka pasur kushtet që të hyjë në rrethin e ngushtë, me kusht që ndërkohë do të sigurojë edhe dokumentin tjetër, por përfaqësuesi nuk është kthyer me dokumentin.

I akuzuari B.L në mbrojtjen e vet ka deklaruar se ka qenë pjesë e hapjes e ofertave lidhur me konkursin e dytë për dërgimin e maturanëve në ekskursion sepse si zëvendës



drejtori i shkollës nuk ka pasur të drejtë të jetë anëtar i Këshillit Drejtues i shkollës. Me datën 03 tetor 2013, drejtori Sh.B e ka ngrirë pozitën e vet për shkak të pjesëmarrjes në fushatën elektorale. Oferta është anuluar dhe gjithçka që ka bërë ishte se ka nënshkruar atë çka ka vendosur Këshilli Drejtues. Me profesion është profesori i historisë e jo jurist dhe ka menduar se çdo gjë është në rregull. Sa i përket pranimit të ankesave nga ana e dy ofertuesve “...” dhe “...”, atë ditë diku në orët e hershme të mbrëmjes, pak pa përfunduar orari i mësimit, agjencitë kanë parashtruar ankesat me shkrim, është e vërtetë që ai ka pranuar ankesat por ka pritur që të vijë drejtori dhe të merret me to. Me datën 06.10.2013 nxënësit kanë shkuar në ekskursion. Në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se në kohën kur është zbatuar procedura e hapjes së ofertave lidhur me realizimin e projektit për dërgimin e nxënësve maurantë në ekskursion, ka qenë zëvendës drejtori i shkollës. Me datën 03 tetor 2013 diku pasdite në orët e mbrëmjes, drejtori e ka njoftuar se prej orës 15:00 e ka të ngrirë pozitën e drejtorit për shkak të pjesëmarrjes në fushatën elektorale dhe se ai duhet të kryej detyrën e drejtorit, kjo bisedë ka qenë verbale. Në bazë të UA është njoftuar se detyrat zëvendës drejtorit merren në momentin kur pushon detyra e drejtorit aktual. Prej datës 03 tetor ka pranuar detyrën e drejtorit të shkollës ndërsa vendimin me shkrim ka pranuar 2 – 7 ditë më vonë, me datën 03 tetor para se të nënshkruhet dokumenti – vendimi, drejtori e ka njoftuar se duhet të jetë pjesëmarrës në mbledhjen e Këshillit të shkollës i cili duhet të mbahet rreth orës 19:00 të asaj dite. Në mbledhje ka luajtur rolin e sekretarit të Këshillit pa të drejtë vote, mbledhja ka zgjatur 40 minuta, të gjithë anëtarët e Këshillit unanimisht janë deklaruar se e kanë përzgjedhur kompaninë “...” për bartjen e nxënësve për në Shqipëri andaj duke u mbështetur në vendimin e shkollës dhe duke patur parasysh situatën e krijuar në mesin e maurantëve, kur ishte shtyrë një javë më parë data e ekskursionit, është krijuar një lloj tensioni dhe në këto rrethana ka nënshkruar vendimin për shkak se data e shkuarjes së tyre në ekskursion ishte caktuar për datën 06 tetor 2013, nuk ka ditur se Këshilli i shkollës gjatë procedimit të tenderit është dashur që vendimin përfundimtar të nënshkruajë pas shqyrtimit të ankesave eventuale të kompanive jo fituese, për këtë arsye ka nënshkruar vendimin e datës 03 tetor si ushtrues i detyrës. Ditën e merkur me 04 tetor rreth orës 18:00, përfaqësuesit e dy kompanive “...” dhe “...” kanë hyrë në zyrën e drejtorit dhe kanë sjellë 1 – 2 zarfe me dokumente, ka qenë i vetëdijshëm se ishte vonë, pas orarit të punës së administratës por në shenjë respekti njerëzor ka pranuar dokumentet, ka ekzistuar një formular dhe ai e ka nënshkruar për të pasur mirëkuptim më vonë. Pavarësisht se nuk ka qenë i njoftuar lidhur me procedurën e tenderimit se a kanë të drejtë në ankesë, ka qenë i vetëdijshëm se ankesat pranohen zakonisht brenda 3 dite, duke llogaritur ditët e punës, pra prej të mërkurës deri në të premten, e meqë në fakt të premten në ora 08:00, nxënësit janë nisur për në Shqipëri, nuk ka informuar anëtarët e Këshillit lidhur me ankesat pasi që disa kanë qenë me nxënësit në Shqipëri ndërsa të tjerët kanë qenë persona privat të zënë me punë të veta, andaj nuk ka pas kurrfarë mundësi që në afatin e duhur ligjor të mblidhen të gjitha anëtarët për të shqyrtuar ankesat e kompanive jo fituese. Sipas procedurës, shpalljen e tenderëve e bënë Këshilli i shkollës dhe pas procedimi finalizohet në DKA, në një komision të përbërë prej tre personave, njeri prej DKA dhe dy nga shkolla, tenderimi i parë ishte anuluar nga DKA për arsye që ata e dinë, me shkrim kanë deleguar kompetencat Këshillit të shkollës që ky organ të organizoj ekskursionet. Prej shkollës si anëtarë të komisionit pranë DKA-së kanë qenë drejtori Sh.B dhe J.H, kur drejtori Sh.. është kthyer i ka informuar se është anuluar ekskursioni dhe se drejtori i DKA nuk do të merret më me procedurën e ekskursionit, drejtori pastaj ka kërkuar prej DKA-së që ky vendim për bartjen e kompetencave të dërgohet me shkrim dhe është informuar se vendimi është pranuar me datën 25 – 26 shtator 2013, në bazë të këtij vendimi drejtori veç e kishte publikuar tenderimin në njërën prej gazetave dhe e ka proceduar deri në ditën e martë kur ka përfunduar.

Dëshmitari G.H ka dëshmuar se është menaxheri i firmës “...”, i kujtohet se lidhur me ekskursionin për vitin 2013 është bërë shpallja e ofertës nga shkolla e mesme- gjimnazi “...” në ..., këtë ka kuptuar me datën 12.09.2013 në DKA dhe në bazë të shpalljes kanë përmbushur ofertën. Nga DKA është ndaluar ekskursioni sepse nuk është bërë oferta në bazë të UA 27/13. Kur ka bërë ankesën në DKA aty ka dëgjuar se është bërë përsëritja e ofertës për të cilën gjë ka kuptuar edhe nga gazeta ditore. Këshilli Drejtues ka bërë përsëri shkelje të UA 27/13 pasi në kushtet e parashtruar si kritere ka qenë edhe rezervimi i hotelit. Personalisht ka qenë prezent në hapjen e ofertës së parë dhe të dytë. Herën e parë i kujtohet se anëtari i komisionit ka qenë N.Ç, për anëtarët e tjerë nuk e din sepse ka qenë e ndaluar hyrja në DKA, mirëpo më vonë në bazë të dokumentacionit ka kuptuar se anëtarë kanë qenë J.H dhe Sh.B nga Këshilli Drejtues. Në ofertën e dytë përveç B.N si kryetar i Këshillit të prindërve kanë qenë Sh.B dhe profesoresha Nimete e cila ka bërë prezantimin e ofertës më të ultë, sa i kujtohet me datën **04 – 04 tetor 2013**, me shkrim është njoftuar se nuk është pranuar oferta e tyre por janë pranuar ofertuesit e tjerë, pastaj ka paraqitur ankesë në zyrën e zëvendës drejtorit. Është shkelur UA 27/13 sepse Këshilli Drejtues ka kërkuar kushtet shtesë si rezervimin e hotelit për 650 nxënës dhe disa kushte të tjera të cilat nuk janë paraparë me UA, prandaj konsideron se oferta është përshtatur ofertuesit “...”. Kur është përsëritur oferta vëllai i tij ka shkuar në Shëngjin dhe ka bërë rezervimin për 650 shtretër në hotelin “...” me e-mail ka ofertuar duke dërguar ofertën së bashku me dokumentet e tjera ndërsa në formë fizike at o i ka pasur me vete atë ditë gjatë hapjes së ofertës dhe ia ka prezantuar komisionit të Këshillit Drejtues, mirëpo komisioni nuk ka njohur ofertën si rezervim dhe kanë kërkuar një vërtetim, ata kanë thënë se kanë shkuar në Shëngjin dhe kanë vërtetuar se nuk ka rezervim të hotelit. Po ashtu kanë formuar komision për shikimin e autobusëve. Mendon se drejtori i shkollës Sh.B ka favorizuar “...” sepse herën e parë gjatë konkursit edhe pse shoferët e autobusëve nuk kanë pasur certifikata shëndetësore, në dosje është shpallë më i favorshëm, por ky konkurs është anuluar me arsyetim se nuk janë respektuar afatet kohore të shpalljes së konkursit. Sh.B ka qenë prezent gjatë hapjes së ofertave dhe një ditë më vonë ka shkuar në vizitë si anëtari i komisioni për verifikimin e rezervimit të hotelit edhe pse nuk ka guxuar me merret me asnjë aktivitet tjetër ngase ka qenë i angazhuar në kampanjën zgjedhore. Kur ka shkuar vëllai im për ta bërë rezervimin e hotelit, pronari i hotelit “...” nuk ka dashur të bëjë rezervimin për ne duke thënë që hoteli tashmë është rezervuar nga “...” dhe drejtori i Gjimnazit u ka thanë atyre që mos të bëjnë rezervimin për askënd tjetër përveç për “...”, kështu që kanë rritur çmimin e ofertës ndaj hotelit “...” dhe kanë lënë kapar 500 € për sigurimin e rezervimit. Konsideron se si kompani kanë pasur ofertën më të lirë se “...”, por jo edhe se “...”. Gjatë hapjes së ofertës përfaqësuesi i “...” ka ardhur 5 – 10 minuta me vonesë dhe ka treguar se licencën e transportit për jashtë e ka me afat të skaduar dhe për shkak të ndryshimit të ligjit Ministria përkatëse nuk lëshon licenca, atëherë dikush ka reaguuar duke i thanë se është dashur të marrë një vërtetim prej Ministrisë përkatëse se nuk lëshohen licencat. Përfaqësuesi i “...” ka shpjeguar se ka kërkuar por nga Ministria ka marrë përgjigje se nuk kanë bazë juridike për të lëshuar atë vërtetim. Ankesën ka parashtruar me datën 04.10.2013, nuk ka pranuar asnjë përgjigje prandaj ka paraqitur rastin në polici. Nuk është dëmtuar sa i përket dëmit material por firma është dëmtuar sa i përket imazhit të saj si firmë jo serioze, nuk parashtron kërkesën pronësoro juridike ndaj asnjërit prej të akuzuarve sepse nuk ka qenë ofertuesi më i liri për tenderim, sipas mendimit të tij ka qenë kompania “...” .

Dëshmitari, i dëmtuari R.K ka dëshmuar se si përfaqësuesi i kompanisë “...” kur është bërë shpallja e ofertës nga Drejtoria e shkollës së mesme “...” për ekskursion të maturantëve për në Shqipëri, në ofertën e parë nuk ka konkurruar pasi që në ftesën për ofertë është parë qartë tendenca e drejtorit të shkollës Sh.B që të përgatitet terreni për kompaninë “...” dhe me qëllim është bërë shkelja e UA nr. 27/13. Tenderin e parë ka anuluar DKA për shkak të parregullsive dhe në ofertën e dytë janë parashtruar kushtet nga Këshilli Drejtues i shkollës

dhe përsëri kanë bërë shkelje të UA pasi që edhe në këtë shpallje janë vërejtur tendencat e drejtorit të shkollës që në afat sa më të shpejtë të realizohet ekskursioni vetëm për të fituar kompania e përzgjedhur nga ai. Në shpalljen e ofertës ka qenë kriter oferta më e përshtatshme ekonomike. Si kompani pos parakushteve kanë dhënë edhe dy mundësi, kanë bërë rezervimin e hotelit "...", si dëshmi kanë bashkangjitur dosjen, në komunikim me hotelin "...", për rezervim për data të caktuara të ekskursionit, menaxheri i hotelit "...", ka informuar se drejtori i shkollës "...", ka kërkuar që mos t'i jepet rezervimi dikujt tjetër pos kompanisë "...", mirëpo me insistim ka arritur të bëjë rezervimin dhe kanë marrë konfirmimin nga hoteli. Këtu kuptohet se drejtori i shkollës ka kryer rezervimin e hotelit dhe përzgjedhjen e kompanisë "...", para se të bëhet shpallja e ofertës edhe pse te rezervimi nuk është zhvilluar konkurrenca, transparenca për turizëm pasi që është përcaktuar lokacioni në Shëngjin dhe përcaktimin e një lokacionit. Këshilli Drejtues i shkollës nuk ka njoftuar saktë numrin e nxënësve që kanë qenë me asistencë sociale, nga familjet e dëshmorëve, të invalidëve të luftës dhe nxënës të dalluar, por bazuar në ofertën si kompani kanë ofruar dy vende falas për çdo autobus si dhe për të gjithë stafin dhe profesorët që marrin pjesë në këto organizime, si dhe falas hyrjen në monumente historike për të gjithë nxënësit dhe profesorët. Oferta ka qenë 94€ për person me pansion të plotë, me kushtet e udhëtimit me komodë duke përfshirë numrin e autobusëve të kompanisë dhe të vitin e prodhimit të tyre. Me datën 10.02.2013, komisioni i vlerësimit ka hapur ofertat ku drejtori i shkollës me tendencë për të eliminuar këtë kompani ka thanë "ju nuk e posedoni licencën e turizmit", në praninë e komisionit ka lexuar Ligjin për Turizëm nr. 04 EL- 176, dhe i ka treguar se licencat e turizmit për veprimtarin e agjencisë turistike janë shfuqizuar dhe nuk ka ekzistuar mundësia që të merret licenca tjetër pasi që ligji ka ndryshuar dhe kjo nuk është i paraparë as me UA 27/13. Në bazë të UA 27/13 kërkohet edhe kontrolli teknik i autobusëve dhe dëshmitë e tyre për këtë janë bashkangjitur në ofertë. Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se bazuar në shpalljen publike në gazetën "...", me datën 25 shtator 2013, nga drejtoria e Gjinnazit "...", në ..., kanë aplikuar por para aplikimit lidhur me shpalljen pasi që ka qenë në kundërshtim me UA, për shkak të parakushteve dhe dëshmimeve nga Këshilli Drejtues kanë bërë ankesën dhe kanë ngritur shqetësime lidhur me shkeljen e ligjeve të Republikës së Kosovës dhe UA. Rezervimin e hotelit në Shëngjin kanë kërkuar për datën 06 deri 11 tetor 2013, siç ka qenë shpallja publike nga shkolla, por është i habitur nga fakti se drejtori i shkollës ka shkuar në këtë hotel dhe ka kërkuar nga menaxheri që rezervimi i hotelit mos t'i jepet askujt përveç kompanisë "...", pasi që në Shëngjin është vetëm një hotel që ofron këto kapacitete. Ankesë ka bërë me datën 04.10.2013 dhe ka dorëzuar në DKA në Prizren dhe në shkollën "...", ku e ka pranuar z. ..., duke kundërshtuar pranimin e ankesës me arsyetim se drejtori nuk është prezent dhe se nxënësit do të shkojnë në ekskursion me datën 06 tetor 2013. Si i dëmtuar parashtron kërkesën pronësoro juridike.

Dëshmitari N.Ç në deklaratën e vet ka theksuar se lidhur me shpalljen e parë që kanë bërë të gjitha shkollat e mesme me një shkresë të veçantë ka kërkuar që të gjithë shkollat të anulojnë tenderin për shkak të mosrespektimit të UA nr. 27/13, kjo ka vlerë po ashtu edhe për Gjinnazin "...". Mirëpo drejtori ka këmbëngulur që të bëhet hapja e ofertave në të cilat oferta përsëri ka pasur parregullsi dhe përsëri ka kërkuar që të mos lejohet shkuarja me këto pa rregullsi. Në ofertën e dytë drejtoria e shkollës shkon edhe më lartë kërkon oferta që fare nuk parashihen me UA, duke e ngarkuar Këshillin Drejtues të shkollës gjoja se ka marrë vendim për kushte shtesë, me kërkesën e kushteve shtesë i ka dhënë favore një operatorit duke mos i bërë të barabartë të gjithë. Nëndërkohë në DKA kanë pasur telefonata nga firma "...", dhe kanë lajmëruar se po bëhen shkeljet duke kërkuar nga DKA që të ndërmarrin masa. I ka udhëzuar ata se ankesat duhen të drejtohen te Këshilli Drejtues i cili hapë ofertën, sepse kompetencat ua ka bartur atyre.. Nëndërkohë oferta ka qenë edhe me datat e kufizuara, me vende të kufizuara dhe kushtet e parapëlqyera në kundërshtim me UA, gjithashtu oferta e dytë ose mbyllja e ofertave dhe dhënia e pëlqimit për shkuarje është bërë

kur drejtorit Sh.B, zyrtarisht ka pushuar puna sepse ka qenë kandidat në zgjedhje, prandaj duke patur parasysh të gjitha këto rrethana dhe parregullësitë nuk ka pranuar që të jetë pjesë e atyre shkeljeve dhe e ka njoftuar drejtorin e policisë e Krimeve Ekonomike dhe kryetarin e Komunës së Prizrenit. Po ashtu te oferta e parë një ofertues i cili është edhe fituesi i tenderit më parë kishte pasur dy oferta në një zarf dhe në çështjen e dytë favorët që ishin në ofertë më tepër ishin në interes të mësimdhënësve se sa të nxënësve që i binte se nxënësit duhej të paguajnë 3 – 4 vizita gjithë kolektivit të shkollës falas. Kanë munguar edhe pëlqimet e prindërve për lejimin e fëmijëve të tyre . Në DKA nuk ka pranuar asnjë ankesë zyrtarisht nga gjimnazi sepse të gjitha gjërat janë bërë shpejtë e shpejtë para se të arrihet data kur drejtori me kompaninë kanë planifikuar të shkojnë në shëtitje dhe raporti i Këshillit të shkollës është dorëzuar pasi që ka përfunduar ekskursioni edhe pse ata kanë pasur për obligim që ta dorëzojnë menjëherë pas hapjes së ofertës. Për shkak të kohës së shkurtër ose përcaktimin e datave, nuk ka marrë pjesë në hapjen e ofertës dhe ajo ka ndodhur në mënyrë që Prokurori i shtetit psh. si sot është bërë hapje ndërsa 2 ditë më vonë është bërë nisja e nxënësve e 10 ditë para nisjes 350 nxënës nga shkolla “...” kanë qenë në protestë se gjoja DKA po pengon shkuarjen në ekskursion dhe kjo ka qenë arsyeja pse nuk ka ndërhyrë në vendimin e Këshillit të shkollës. Sa i kujtohet ka qenë kërkesa edhe për ndërrimin e destinacionit nga oferta e parë sepse oferta e parë ka qenë në Durrës kurse oferta e dytë për Shëngjin, në një hotel me kapacitet të caktuar. Për shkak të mungesës së raportit të Këshillit të shkollës ose dorëzimit me vonesë, e në anën tjetër njoftimit për nxënësit se brenda atyre ditëve do të nisen në ekskursion, si drejtor i DKA ka qenë i obliguar të autorizonte Këshillin e shkollës sepse nuk kanë ekzistuar gjasa që për atë periudhë të shkurtë të bëhet përzgjedhja sipas procedurave të rregullta ku ai do të ishte anëtari i komisionit, për të cilën procedurë së paku ka qenë e nevojshme 7 – 8 ditë . Sipas ligjit kur mungon drejtori barra e përgjegjësisë bie në zëvendës drejtorin, në raste kur shkolla nuk ka zëvendës drejtorin atëherë DKA i propozon Kryetarin të Komunës që ta caktojë një ushtrues detyre meqë zgjedhja e drejtorit dhe zëvendës drejtorit nuk është kompetenca e DKA-së. Të gjitha oferta janë anuluar nga DKA sepse para mbylljes së ofertave operatorët konkurrues janë ankuar në policinë e krimeve se nuk janë zbatuar të gjitha udhëzimet administrative dhe pas diskutimit me polici kanë dhënë një urdhëresë që të anulohen të gjitha ofertat për të gjitha shkollat dhe ky problem nuk është tejkaluar pasi që flitet për tri certifikata, në UA shkuan licencë por nuk ceket cila licencë dhe kjo ka qenë shkak kryesor i anulimit, kurse Ministria e Transportit në faqen e vet kërkon licencën për të gjithë transportuesit jashtë shtetit ndërsa në UA mungon sqarimi cila është ajo licencë e në anën tjetër ka shkaktuar reagime edhe te nxënësit për shkak të mospërputhjes së datave për shkuarjen në ekskursion.

Dëshmitari H.K ka dëshmuar se ka qenë anëtari i Këshillit për zgjedhjen e konkurruesve për tender për transportimin e nxënësve në ekskursion vetëm një herr i ka thirrur drejtorin që të zëvendësojë një anëtarë të cilit i ka skaduar mandati, por emëri nuk i kujtohet, në atë mbledhje ka ardhur me vonesë dhe kur kanë hyrë ofertuesit ka dëgjuar se njeri prej tyre ka bërë titull duke u drejtua komisionit me një dokument në duar me fjalë “pse keni kërkuar këtë dokument sepse nuk ekziston në Ligj, pari që Ligji është ndryshuar “ ka shpjeguar edhe diç prej ligjit por nuk e njoh ligjin në atë mbledhje janë vlerësuar çmimet e ofertave, vendet pa pagesë për fëmijët e dëshmorëve, një prej kushteve ka qenë transporti, komoditeti, restoranti etj dhe kushtet e ofertuesve, nuk i kujtohet atë ditë apo ditën tjetër është vendosur për fituesin.

Dëshmitari E.K ka dëshmuar se si anëtari i Këshillit Drejtues i shkollës dhe përfaqësuesi i prindërve në momentin kur fëmijët është dashur të shkojnë në ekskursion, në bazë të shikimit të dokumentacionit Këshilli Drejtues i shkollës ka vendosur që tenderin ia japë Agjencisë Turistike “...” . Në atë takim ka qenë prezent edhe drejtorin Sh.B i cili ka pasur

rolin e sekretarit por pa të drejtë votimi, ai vetëm ka mbajtur procesverbalin. Kryetari i Këshillit ka qenë B.N i cili kur është hapur tenderi për secilën firmë veç e veç e ka dorëzuar dokumentet dhe secili anëtar ka shikuar dokumentin dhe secili dokument është evidentuar. Atëherë kanë qenë prezentë edhe përfaqësuesit e firmave përveç përfaqësuesit të “...” i cili është vonuar 10 – 20 minuta. Pas shikimit të dokumenteve ka filluar procedura e vendosjes, zgjedhjes së tri firmave të cilat i plotësojnë kriteret me kushte më të volitshme. Pas largimit të përfaqësuesve anëtarët e Këshillit kanë filluar vlerësimin e ofertave dhe për të gjithë ka qenë e rëndësishme të zgjidhej firmën e cila do të ishte më i sigurt dhe e cila do të plotësonte kushtet më të volitshme, prandaj janë zgjedhur firma “...”, “...” dhe “...”. Këshilli drejtues ka vendosur rregulla të cilat ata duheshin t’i plotësonin, pra kanë vendosur që të bëhet shikimi në autobusë se a janë në rregull dhe a kanë bërë rezervimet. Sipas dokumentacionit vetëm “...” ka pasur rezervim në një hotel në Shëngjin por nuk ka parë dokumentin lidhur me atë. Ditën tjetër tre përfaqësues të Këshillit Drejtues kanë shkuar dhe kanë bërë shikimin e autobusëve të kompanive “...” dhe “...”, ndërsa komisioni në përbërje prej një nxënës, kryetarit të Këshillit B.N dhe drejtorit të shkollës Sh.B, kanë shkuar në Shqipëri për të shikuar kushtet në hotelin i cili ka qenë i rezervuar. Pas raportit verbal të kryetarit të Këshillit kanë vendosur për fituesin e tenderit “...” e cila sipas vlerësimeve të tyre ka ofruar kushtet më të mira. I kujtohet që kompania “...” nuk ka pasur licencën e Ministrisë së Industrisë dhe Turizmit, nuk i kujtohet se në një mbledhje pas anulimit, kryetari i Këshillit apo drejtori i shkollës ka hapur mbledhjen dhe ka informuar për anulimin e tenderit sepse nuk kanë qenë të plotësuar disa kushte apo disa afate kohore të përcaktuara.

Dëshmitari F.G ka deklaruar se kanë qenë operatori me ofertë më të volitshme sepse kanë pasur më shumë vende falas për diku 47 nxënës, lidhur me numrin e këtyre nxënësve që shkojnë gratis vendosin vet, pra kanë pasur kushtet më të mira, kanë shërbyer me ushqim dhe pije shtesë dhe kanë pasur një racion gjatë udhëtimit. Pagesa nga shkolla është bërë ashtu që një pjesë të pagesës kanë kryer para nisjes në ekskursion ndërsa pjesën tjetër pas përfundimit, të hollat janë dorëzuar në dorë. I kujtohet që në ekskursion kanë shkuar rreth 540 nxënës, pagesa për një nxënës ka qenë 88 € për 5 net dhe 6 ditë. Përveç nxënësve ka pasur vende edhe për profesorët kujdestarët e klasave. Në ofertën ka qenë e paraparë që të organizohet vizita për Këshillin e shkollës dhe nxënësve dhe pagesa ka qenë simbolike. Për rezervimin e hotelit ka shkuar me vëllain K.G në Shëngjin në hotelin “...”, ku janë takuar me menaxherin e hotelit, me emër M.. dhe kanë bërë rezervimin e hotelit sepse ka qenë e pamundur që të pranojnë nxënësit e shkollës meqë në hotel kanë shkuar për herë të parë, gjatë rezervimit kanë paguar 1000 €. Rezervimi i hotelit nuk ka qenë kusht për të fituar ofertën por për shkak të numrit të madh të nxënësve vetëm ky hotel ka mund të plotësoj kushtet me kapacitetin, prandaj shkolla ka kërkuar rezervimin e hotelit me ofertën e parë dhe të dytën kur ka ofruar të gjitha para kontratës dhe dëshminë e pagesës për rezervimin e hotelit. Në rishpalljen e ofertës është kërkuar rezervimi i hotelit por nuk i kujtohet kush ka kërkuar.

Dëshmitari N.V ka dëshmuar se në vitin 2013 ka qenë anëtar i Këshillit Drejtues të shkollës “...” në ... kur shkolla ka marr vendim për përzgjedhjen e kompanisë dhe fituese ka qenë kompania “...”. Kryetari i Këshillit ka qenë B.N, si përfaqësues i prindërve, po ashtu si përfaqësues i prindërve kanë qenë si anëtarët E.K dhe H.K, N.V, J.H, S.M, mësimdhënësit dhe një nxënës nuk i kujtohet emri. Sh.B ka pasur kompetencë përmbajtjen e procesverbalit pa të drejtë vote. Këshilli Drejtues vendimet i merr me shumicën e votave, të gjithë anëtarët janë të barabartë . Kryetari i Këshillit e hap mbledhjen dhe ka rolin e barabartë me anëtarët e tjerë. Nuk ka përvojë lidhur me ekskursione, në këtë rast ka vendosur DKA, ndërsa tenderin dhe krejt kriteret e tenderit ka shpallë shkolla, në kohën e fundit shumë shpesh janë ndryshuar Udhëzimet Administrative lidhur me këtë çështje. I kujtohet se kompania “...” ka plotësuar kushtet edhe atë me më tepër vende gratis për fëmijët me ndihma sociale, diku 60 vende,

autobusët kanë qenë në rregull, kanë pasur licencë për transport dhe rezervimin e hotelit ndërsa kompanitë e tjera nuk kanë pasur licencë, rezervimin e hotelit dhe çmimi i ofruar dhe sigurimi për nxënës ka qenë më i volitshëm nga kompania "...". Asnjëri prej anëtarëve të Këshillit nuk ka pasur ndonjë ndikim apo sugjerim, zëvendës drejtori në atë mbledhje ka pasur rolin e drejtorit si sekretar në mungesë të tij. Përzgjedhja e kompanisë "..." është bërë para se të merr detyrën si zëvendës drejtorit i akuzuari B.L. I kujtohet që në atë kohë kanë qenë protestat e maturantëve e shkollës "..." në DKA sepse është vonuar vendosja për tender, lidhur me tender më herët ka vendosur DKA-ja, por vendimin për përzgjedhjen e kompanisë fituese kanë anuluar edhe pse votat kanë qenë 2 me 1 për kompaninë "...". Nuk i kujtohet pse është anuluar konkursi i parë dhe a ka pasur sugjerime nga DKA se si duhet të veprohet në përzgjedhjen dhe cilat pengesa duhet të eliminohen, konsideron se Këshilli Drejtues ka përpiluar kriteret në bazë të UA i cili ka qenë në fuqi në atë kohë, si konkurrent në atë kohë kanë qenë edhe "..." dhe "..." dhe këto dy kompani nuk kanë përmbushur kushtet të cilat janë kërkuar me ofertë, se si kusht ka qenë licenca për transportim. Komisionet nga Këshilli Drejtues kanë konstatuar se "..." ka plotësuar kriteret sa i përket autobusëve të cilët kanë qenë në gjendje teknike të mirë, po ashtu ka konstatuar se posedojnë rezervimin e gatshëm pasi që kanë marrë konfirmimin për rezervim dhe kanë shkuar në Shëngjin në hotelin "..." ku kanë biseduar me pronarin e hotelit, në këtë komision kanë qenë kryetari i Këshillit Drejtues B.N., një nxënës dhe një anëtarë por nuk i kujtohen emra, ndërsa dy kompani të tjera kanë pasur vetëm në letër kinse kanë rezervim, ndërsa komisioni gjatë konfirmimit në hotel nuk kanë vërtetuar këtë fakt, dokumenti i "..." ka qenë i dërguar në mënyrë elektronike prandaj për Këshillin nuk ka pasur vlerë, ata nuk kanë pas rezervimin edhe pse gjatë konkurrimit kanë treguar se posedojnë.

Dëshmitari J.H ka dëshmuar se në atë kohë Sh.B ka qenë anëtar i Këshillit sipas funksionit si drejtor, nuk i kujtohet a ka votuar kur është bërë përzgjedhja e kompanisë fituese. Katër vite ka punuar si anëtar i Këshillit të shkollës, gjatë zgjedhjes së tenderit përveç pjesës ligjore të cilën si anëtar i Këshillimit nuk e njeh mirë, por ka përgjegjësi morale ndaj fëmijëve, prindërve që zgjedhja e kompanive përveç pjesës ekonomike të jetë edhe e besueshme, sepse dy vite më herët kanë pasur kompaninë "..." e që nuk ka plotësuar kushtet. Të gjithë anëtarët e Këshillit kanë prë ofertat dhe si ofertë që ka plotësuar kushtet në atë mbledhje më e mira ka qenë kompania "..." e cila ka pas rezervim për 600 nxënës, këto e di sepse kanë dërguar kryetarin e Këshillit B.N dhe drejtorin Sh.Bn për të vërtetuar se a kanë rezervime edhe kompanitë e tjera, sepse të gjithë kanë treguar se posedojnë rezervimin e gjatë vizitës komisioni ka vërtetuar se vetëm "..." ka poseduar rezervim, ndërsa jo edhe dy kompanitë e tjera edhe pse kanë thanë se kanë rezervime. Pasi kanë analizuar kushtet e të gjitha ofertave në prezencën e përfaqësuesve të kompanive kanë konstatuar se kompania "..." ka qenë më e favorshme dhe votimi ka qenë unanimit. Sa i kujtohet dy herë është shpallë konkursi, herën e parë është anuluar për shkaqe procedurale, ka qenë në pyetje koha sepse nuk ka kaluar një muaj ditë për shqyrtimin e tenderit sipas UA dhe kjo është eliminuar, mandej është shpallur tenderi i dytë dhe kompetencat i janë bartur shkollës për të vendosur për hapjen e tenderëve. Për tenderin e parë ka qenë drejtori në funksion Sh.B dhe në asnjë mbledhje nuk ka marrë pjesë B.L as në tenderin e parë e as në të dytin derisa kanë përcaktuar ofertuesin. Gjatë hapjes së tenderit të dytë kryetari i Këshillit B.N secilin dokument të secilës kompani u ka treguar anëtarëve në shikim në prezencën e kompanive, anëtarët e Këshillit pasi kanë kontrolluar dokumentet kanë konstatuar se kush i ka plotësuar kushtet e parapara me konkurs, pastaj kanë diskutuar për çmimet për secilën kompani dhe kanë vendosur që fituesi më i volitshëm të jetë "...". Pasi që ka ndodhur që gjatë udhëtimit e mëhershme kanë pritur në kufi 24 orë, Këshillimi Drejtues ka konsideruar se duhet të kenë kujdes të shtuar gjatë zgjedhjes dhe se ofertuesi – kompanitë të kenë autobusët në rregull dhe është formuar një komision për teren i cili ka pasur për detyrë të vizitojë secilën kompani dhe të kontrollojë se

a kanë autobusët në rregull, madje vetë ka qenë anëtari i komisionit së bashku me Safer Mrasolli , kanë shkuar në kompaninë "... " e cila ka pasur tre autobusë ndërsa "... " 7 – 8 autobusë, mirëpo te kompania "... " nuk kanë shkuar sepse kanë lënë takimin në ora 18:00 – 19:00, por përfaqësuesi i kompanisë nuk ka ardhur në shkollë për të dalë në teren sipas marrëveshjes. Një vit më herët kanë udhëtuar me kompaninë "...", kanë qenë shumë korrekt, kanë pasur gratis për nxënësit të varfër në çdo autobusë nga dy vende dhe për profesorin kujdesta, ndërsa në tenderin e fundit "... " ka pas tre vende gratis për nxënës në çdo autobus si dhe për kujdestarët e klasës dhe dy udhëtime jashtë sezonit për të gjithë profesorët e gjimnazit dhe edhe kjo ka qenë një kriter. Pasi që kompania "... " nuk ka pasur licencë për udhëtim jashtë vendit ka qenë një argument i cili ka frikësuar Këshillin sepse me të njëjtën gabim kanë humbur tenderin një vitë përpara, relacioni i shkollës me "... " ka qenë korrekt dhe përfaqësuesi i kompanisë "... " në fillim ka premtuar se do të sjellë më vonë licencën dhe për këtë arsye nuk ka qenë i përjashtuar nga lista e ngushtë, ndërsa kompania "... " ka poseduar licencën. Mendon se është vendosur sipas procedurave të paraparë me udhëzimin administrativ.

Gjatë shqyrtimi kryesor janë lexuar provat materiale:

-procesverbali i mbledhjes të Këshillit Drejtues të shkollës të mbajtur me datën 27.08.2013 ku si pikat e rendit të ditës kanë qenë organizimi i ekskursionit për maurantët për vitin shkollorë 2013 – 2014, zgjedhja e kryetarit të Këshillit drejtues të shkollë dhe të ndryshme.

- vendimi i Këshillit Drejtues të shkollës të datës 27.08.2013 me të cilën Këshilli Drejtues i shkollës pas shqyrtimit Udhëzimi Administrativ 27/13 unanimitisht vendos që ekskursioni i maurantëve të realizohet kah java e fundit e muajit shtator 23 – 25 shtator ose në fillim të muajit tetor 01 – 10 tetor dhe ekskursioni i maurantëve do të realizohet në Republikën e Shqipërisë varësisht nga ofertat e kompanive në cilat qytete do të ofrojë komoditet më të mirë për maurantë dhe lartësia e pagesave për maurantë do të duhej të sillej prej 90 – 110 €. Qëllimi i ekskursionit është edukativo arsimor dhe itenerali do të jetë vizita nëpër qytete historike të Shqipërisë dhe ekskursioni do të zgjat 5 ditë mësimi.

-kërkesa nga KD i shkollës "... " në ... e ushtruar pranë DKA në Prizren me datën 08.09.2013 që të jetë për marrjen e pëlqimit për organizimin e ekskursionit të maurantëve, për vitin shkollor 2013 – 2014 me të cilën njoftojmë DKA se paraprakisht kanë marr pëlqimet e prindërve të nxënësve maurant dhe kërkesa e nxënësve dhe e prindërve është që ekskursioni të realizohet kah fundi i muajit shtator ose fillimi i muajit tetor e nënshkruar nga drejtori i shkollës Sh.B dhe kryetari i KDSH B.N.

-ftesa për ofertën nga Drejtoria e Gjimnazit "... " në ... me nr. 349 të datës 12.09.2016 me të cilën ftojnë ofertuesit e kualifikuar ATO që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maurantëve me kushtet e parapara dhe dokumentacion e nevojshme edhe atë certifikatën e biznesit, dëshminë për pagesën e taksave komunale për vitin 2013, dëshminë e administratës tatimore për vitin 2013, licencën e lëshuar nga organet përkatës (Ministria Tregtisë dhe Industrisë, Departamenti i Turizmit dhe nga Ministria e Transportit), referencat rreth organizimit të ekskursioneve për nxënës, fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore, autobusat me konformë dhe me klimë dhe Agjencitë të kenë përpiluar agjenten për ekskursion në detaje, duke përfshirë vizitat e vendeve historike – turistike si dhe akomodimin e nxënësve dhe kohën e rezervimit të hoteleve. Afati i paraqitjes në tender është deri me datën 19.09.2013 në ora 14:00, hapjen e ofertave e bënë komisioni sipas UA 27/13 me datën 20.09.2013 në ora 14:30 minuta në

ambientet e DKA Prizren dhe kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike.

-pëlqimi i DKA në Prizren me nr. 596/13 të datës 13.09.2013 me të cilën lejohet nisja e procedurave për realizimin e ekskursionit për maurantët dhe kujdestarët e klasave të Gjimnazit “...” në Prizren sipas itinerarit të përcaktuar me vendim të Këshillit të Shkollës dhe obligohet drejtori i shkollës që të veprimi në bazë të UA nr. 27/13 të datës 18.06.2013, e nënshkruar nga Drejtori i Arsimit në Prizren N.Ç.

-procesverbali i mbledhjes së Këshillit Drejtues të shkollës i mbajtur me datën 20.09.2013 me rendin e ditës : ekskursioni i maurantëve të vitit shkollor 2013 – 2014 ku në bazë të raportit të komisionit për hapjen dhe vlerësimin e ofertave është konstatuar se vlerësimi i drejtorit të shkollës dhe i anëtarëve të KDSH ishte që ekskursioni e maurantëve të realizoi “...” nga Prizreni sepse kishte ofruar kriteret më të mirë ekonomike për nxënës dhe vizita gratis nëpër monumente historike për dallim nga “...” .

-procesverbali nga komisioni për vlerësimin e ofertave për realizimin e ekskursionit për nxënës e shkollës së mesme pa datë me të cilën konstatohet se hapja e ofertave në prani të komisionit në përbërje të N.Ç drejtori i DKA, J.H anëtari i Këshillimit dhe Sh.B drejtori i shkollës kanë konkurruar katër firma edhe atë “...”, “...”, “...” dhe “...” edhe pas shqyrtimit të ofertave kompanive komisioni vlerëson dhe u pajtuan që të përzgjedhin si ofertuesit “...” dhe “...” .

-vendimi i Këshillit Drejtues të shkollës i datës 20.09.2013 në të cilën konstatohet se Këshilli Drejtues i shkollës pas shqyrtimit me vëmendje procesverbalin nga komisioni për hapjen dhe vlerësimin e ofertave morri vendim që ekskursionin e maurantëve të realizohet nga Agjensioni turistik “...” nga Prizreni prej datës 29.09.2013 deri më datën 04.10.2013 dhe lartësia e pagesës për nxënës do të jetë 107 € , me tre vende gratis në për nxënës dhe vizita gratis në monumentet historike. Vendi ku do të shkojnë është Republika e Shqipërisë, akomodimi do të jetë në Shëngjin në kompleksin e hoteleve “...”

-vendimi i datës 23.09.2013 me të cilën është vendosur nga komisioni në përbërje N.Çdrejtori i DKA, Sh.B drejtori i shkollës, dhe J.H anëtarë që të zgjidhet Kompania “...” dhe “...” dhe prej dy kompanive zgjidhet “...” me ofertë 107 € (tre nxënës) gratis për autobus dhe ekskursion do të realizohet me datën 29.09.2013.

-qëndrimi i DKA me nr. 628/13 datës 23.09.2013 – drejtor N.Ç me të cilën kërkohet të përsëritet ftesa për ofertë për ekskursionin e maurantëve për Gjimnazin “...” dhe të shpallet oferta në përputhje me UA 27/13 të datës 18.06.2013 dhe nuk pranohet nga ana e Drejtorit të DKA vendimi i komisionit të datës 23.09.2013 pa numër të protokollit i hartuar dhe i nënshkruar një anshëm nga përfaqësuesit e shkollës në fjalë për përcaktimin e kompanisë turistike “... Trans” pasi që drejtori ka deklaruar se nuk do të nënshkruaj këtë vendim dhe nuk mbanë asnjë përgjegjësi për rrjedhjen e mëtejme në lidhje me pasojat e këtij vendimi.

-vendimi nr. 642/13 të datës 24.09.2013 nga drejtori i DKA N.Ç me të cilën anulohen të gjitha ftesa për oferta për realizimin e ekskursioneve për shkollat të mesme të Komunës së Prizrenit, përsëritja e ftesës për oferta për të gjitha shkollat e mesme për realizimin e ekskursioneve të maurantëve dhe të shpallen oferta në përputhje me UA 27/13 të datës 18.06.2013 përkatësisht të definohen vendimet e Këshillave të shkollave në lidhje me intenerarin dhe kohën e nisjes, gjithashtu të shtohet në ofertë kërkesa për dëshminë për shëndetin fizik dhe mendor të vozitësve siç parashihet në UA 27/13 dhe obligohen shkollat që



vendimet e Këshillave të shkollave të bëjnë publike në lidhje me pikën 2 të nenit 11 të UA 27/13.

-e-mail i drejtorit të DKA N.Ç me datën 24.09.2013 i drejtuar drejtorit të shkollës “...” Sh.Bt etj me të cilën kërkon që të mos caktohet data e hapjes së ofertave pa bisedë paraprak me drejtorin e DKA sepse atë ditë që vendosi ju si shkolla ndoll që drejtori të mungoj në punë për shkak të angazhimeve.

-procesverbali i mbledhjes të KDSH me datën 24.09.2013 me rendin e ditës anulimi i kushtit për ofertë për ekskursionin të maurantëve të shkollës “...” dhe përsëritjes së re . Konstatohet se në këtë mbledhje mungon kryetari i KDSH B.N por drejtori i shkollës në cilësinë e sekretarit të KDSH i njoftoj të pranishmit për qëndrimin e drejtorit të DKA për anulimin e ofertës të datës 13.09.2013 sepse janë bërë disa lëshime procedurale .

-vendimi nr. 491/1 të datës 24.09.2013 e marrur nga Këshillimi Drejtues i shkollës , në përbërje të plotë unanimisht për anulimin e kërkesës për ofertë e shpallur me datën 13.09.2013 në gazetën ditore “...”, përsëritet oferta duke i parashtruar edhe kushtet e ofertës , ekskursioni i maurantëve të realizohet me datën 06.10.2013 në R. e Shqipërisë dhe data e kthimit 11.10.2013 dhe agjendën prej ditës së parë deri në ditën e gjatës kur kthehen në Prizren, lartësia e pagesës do të jetë prej 90 – 110 € e nënshkruar nga kryetari i KDSH B.N.

-përsëritja e ofertës për ekskursion të maurantëve të shkollës së mesme të lartë Gjinnazi “...” në Prizren numri 491 të datës 24.09.2013 me të cilën ftohen ofertuesit e kualifikuar që të paraqesin ofertat e tyre në zarfe të mbyllur , dokumentacioni i nevojshëm dhe kushtet e parapara edhe atë : rezervimi i hotelit në Shëngjin i cili posedon mbi 650 shtretër sallën për ballo, kompania të siguroj mjekun e kualifikuar për kujdesin shëndetësor dhe të përcaktohet çmimi i ofertës për një nxënës për 6 ditë ekskursionit dhe lehtësira për nxënësit me asistentë sociale ata që kanë statusin e familjes së dëshmorit .

-vendimi i drejtorit DKA N.Ç me nr. 666/13 të datës 01.10.2013 për delegimin e kompetencave me të cilën autorizohet drejtori i Gjinnazit “...” z. Sh.B dhe Këshilli Drejtues i shkollës që të bëjnë përzgjedhjen e Agjencionit turistikë për realizimin e ekskursionit me maurant, sipas kriterëve të parapara me UA 27/13 dhe që drejtori i Gjinnazit dhe Këshilli Drejtues i shkollës të marrin ofertat në DKA ku janë dorëzuar nga ofertuesit .

-oferta e Agjencionit turistik “...” për ekskursionin e maurantëve shkollës “...” me të cilën ofron 5 pansione të plota, mëngjes, drekë dhe darkë plus transporti, mjeku kujdestar dhe muzikë, vendosja në hotelet “...” në Durrës ose sipas kërkesës së Drejtorisë së shkollës dhe në hotel “...” në Shëngjin , 94 € për person pansion i plotë plus muzika të gjallë, dy nxënës gratis në autobus, grati autobusi për shërbimet e udhëtimit për gjithë profesorët e shkollës dhe stafi nga drejtoria që marrin pjesë në pushimin pranveror në Shqipëri, gratis gjithë profesorët e shkollës dhe stafi nga drejtoria që marrin pjesë në këtë organizim , gratis udhëtimi me autobusë për profesorët e shkollës me organizim pune njëditore në Kosovë, pije ëmbëlsira dhe shërbime tjera në autobusë dhe hyrja në monumente gjatë vizitave . Poashtu janë dhënë udhëzime dhe Agjencia posedon licencën , kanë realizuar numër të konsiderueshme të udhëtimeve, stafi është specializuar për udhëtime, posedojnë kontratën dhe referenca të shumta për fushën e organizimeve të udhëtimeve, Agjencioni posedon autobusët të klimatizuar dhe kushtet tjera e poashtu ka edhe agjentin specifikuar sipas ditëve.

-oferta e kompanisë “...” drejtuar SHML “...” në të cilën janë ofruar informacionet shtesë mbi ofertën, metodologjia e planifikuar për realizimin e ofertës, konfirmimin e

rezervimit të hotelit , realizimi i ekskursionit mund të bëhet me datën 06.10.2013 deri 11.10.2013 me çmim 105 € për nxënës në kuadër të këtij çmimi përfshinë edhe udhëtimin gratis për 5 nxënës për autobus, tre herë shërbime udhëtimi për mësimitdhënësit e shkollës për pushim disa ditësh në Shqipëri sipas kërkesë nga shkolla si dhe çdo vizitë që i bëhet institucioneve të caktuara në Kosovë për nxënës dhe mësimitdhënës, gjatë udhëtimit sandviçë, pije të ftohta, kafë, ëmbëlsira dhe shërbime tjera në autobusë, hyrje në momentet historike gjatë vizitave të maturantëve në Shqipëri dhe për mbrëmje tupanat. Akomodimi i nxënësve do të bëhet në hotelin “...” në Shëngjin etj.

-procesverbali i mbledhjes së KDSH të mbajtur me 02.10.2013, me rendin e ditës hapja e ofertave të kompanive turistike për ekskursionin e maturantëve ku drejtori i shkollës në cilësinë e sekretarit KDSH i njofton të pranishmit me vendimin e drejtorit të DKA nr. 666/13 të datës 01.10.2013 për delegimin e kompetencave të KDSH për hapjen dhe vlerësimin e ofertave nga kompania turistike për organizimin e ekskursionit të nxënësve në prezencën e përfaqësuesve e kompanive kur është vendosur që Agjencia “Bashkimi Reisin” eliminohet në start, Agjencia “...” dhe “...” komisioni të shkojë në teren për verifikimin e gjendjes së autobusëve ndërsa pasi që përfaqësuesi i kompanisë “...” nuk është paraqitur është vendosur që komisioni të mos shkon tek ata.

-tabela e vlerësimit të ofertave të datës 03.10.2013 nga KDSH “...” në Prizren nga e cila vërtetohet se janë përzgjedhur kompania “...” me poenë 65 dhe “...” 95.

-tabela e hapjes së ofertave të datës 02.10.2013 nga Këshilli Drejtues i shkollës “...” nga e cila vërtetohet se kanë konkurruar 5 kompani dhe atë: “...” me çmim 107 €, “...” me çmim 110 €, “...” 105, “...” 98 € dhe “...” 94 €.

-procesverbali i mbledhjes së KDSH të mbajtur me datën 03.10.2013 në rendin e ditës vlerësimi i ofertave të Kompanive turistike për organizimin të ekskursionit dhe përzgjedhja e kompanisë fituese . Në pikën 1 është konstatuar se në rrethin e ngushtë për vlerësimin janë marrë parasysh tri kompani ofertuese “...”, “...” dhe “...” dhe se gjatë vlerësimit pasi që kompania “...” ka licencën e skaduar të Industrisë dhe Turizmit e njëjta eliminohet . B.N kryetari i KDSH , A.H dhe Sh.B, delegacioni i cili ka shkuar në Shëngjin për të interesuar rreth rezervimit të hotelit i cili kusht është paraparë si kusht e ofertës kanë verifikuar se vetëm “...” posedon rezervimin prandaj nga anëtarët e komisionit është vendosur që vetëm dy kompani të hyjnë në rrethin e ngushtë edhe atë: “...” dhe “...”. Në pikën 2 është konstatuar se në bazë të vlerësimit të gjitha kushteve në ftesë për ofertë KDSH me 95 pikë shpallë fituesin kompaninë “...” ndaj kompanisë “...” me 65 pikë.

-vendimi nr. 564 të datës 03.10.2013 me të cilin është vendosur që “...” nga Prizreni me çmimin 105 €, nga 5 nxënës gratis për autobus fiton të drejtën për realizimin e ekskursionit të maturantëve me datën 06.06.2013, e nënshkruar nga zëvendës drejtori i shkollës B.L .

-regjistri i nxënësve maturantë për ekskursion sipas klasave i përpiluar me datën 05.10.2013, për ekskursion 2013 – 2014 .

-kërkesa e përbashkët drejtorit të shkollës Sh.B, kryetarit të KDSH B.N të datës 08.09.2013 për organizimin e ekskursionit të maturantëve për vitin shkollor 2013 – 2014 me të cilën njoftojnë se kanë marrë pëlqimin e prindërve të nxënësve maturant dhe kërkesa e nxënësve dhe prindërve është që ekskursioni të realizohet ka fundi i muajit shtator ose fillimi i muajit tetor, drejtuar pranë DKA në Prizren.

-vërtetimi mbi rezervimi e hotelit “...” në Shëngjin me të cilën vërtetohet se kompania “...” ka kryer pronotimin për akomodim me pansion të plotë të nxënësve të shkollave të mesme të Prizrenit për periudhën nga data 06.10.2013 deri më datën 11.10.2013 si dhe marrëveshja e datës 01.10.2013 me të cilën shkresë konfirmohet nga “...” se me rastin e tenderimit me sukses për grupet e shkollave të Prizrenit do të paguaj “...” çmimin prej 13 € për akomodimin me pansion të plotë dhe për këtë arsye bëhet edhe një parapagim nga “...” prej 500 € si garanci e në kundërtën shuma e mësipërme rikthehet e plotë dorëzuesit. Në rastet shpalljes fitues “...” është i obliguar të paguaj brenda datës 03.10.2013 shumën tjetër paradhënie prej 3000 € pranë “...”. Si dhe oferta e hotelit “...” .

- ankesa NTT “...” e pranuar në DKA me datën 04.10.2013 e protokolluar me nr. 704 në të cilën ekziston konstatimi u pranuar me 04.10.2013 nga zëvendës drejtori B.L.

-ankesa NTT “...” të datës 23.09.2013 protokolluar në DKA nr. 630 për Drejtorin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në Prizren .

- përgjigja nga drejtori i DKA N.Ç me nr. 633/13 të datës 24.09.2013 në të cilën konstatohet se për shkak të parregullsive në procedurat e shpalljes së ofertës dhe mos plotësimi i kriterëve përfaqësuesi i DKA-së nuk pranon që të jetë pjesë e vendimit për kompaninë e përzgjedhur. Ndërsa anëtarët e komisionit përfaqësuesi i Këshillit Drejtues të shkollës , J.H (pa autorizim nga kryetari i Këshillit të shkollës) dhe UD drejtorit të Gjinnazit “...” z. Sh.B kanë marrë vendim në lidhje me përzgjedhjen e kompanisë turistike. Vendimi në fjalë është marrë shkolla ndërsa në anën tjetër nuk figuron logoja e shkollës por institucioneve komunale , andaj duhet ti drejtohen komisionit që e ka hartuar dhe nënshkruar vendimin ndaj të cilit janë ankuar .

- ankesa e “...” me nr. protokollit 581 të datës 04.10.2013 e drejtuar drejtorit të Gjinnazit dhe Këshillit të shkollës “...” dhe pranë DKA me nr. 705 të datës 04.10.2013 në të cilën ekziston konstatimi se u pranua ankesa me 04.10.2013 nga B.L.

-UD 27/13 të datës 18.06.2013 ku në nenin 11 është i paraparë organizimi i ekskursionit për maurantë.

Në bazë të provave të administruara gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me datën 27.08.2013 KSHD i shkollës “...” në ... ka marrë vendim për realizimin e ekskursionit në Shqipëri, për javën e fundit të shtatorit ose në fillim të muajit tetor, për lartësinë e pagesës prej 90 deri 110 € dhe përzgjedhja do të bëhet varësisht prej ofertës më të mirë të Agjencive Turistike. Me datën 09.09.2013, drejtori i shkollës dhe KDSH kanë bërë kërkesën në Drejtorin Komunale të Arsimit, me nr. protokoli 319, për të marrë pëlqim për ekskursion dhe me datën 12.09.2013, nga shkolla “...” është shpallë oferta për ekskursion të maurantëve, me nr. 349. Me datën 13.09.2013 me numër të referencës 596/13 DKA jep pëlqim për shkollën “...” dhe lejohet nisja e procedurave për realizimin e ekskursionit për maurantë dhe obligohen drejtorët që të veprojnë në bazë të UA nr.27/13.Me datën 20.09.2013 në DKA në Prizren është formuar komisioni në bazë të UA 27/13, është bërë hapja e ofertave për shkollën “...” ku si anëtarë janë caktuar drejtori i DKA N.Ç, J.H nga Këshilli i shkollës dhe Sh.B drejtori i shkollës dhe është bërë zgjedhja e katër kompanive “...”, “...”, “...” dhe “...”, e cila është përzgjedhur fituese me pagesën prej 107 € për nxënës, tre vende gratis për nxënës në çdo autobus dhe vizita gratis në monumente historike . Me datën 23.09.2013 drejtori i DKA N.Ç, me referencën numër 628/13 iu drejtua drejtorisë së gjinnazit “...” në ... me qëndrim që të përsëritet ftesa për ofertë për ekskursionin e maurantëve për Gjinnazin “...” dhe të shpallet oferta me përputhje me UA 27/13 e datës

18.06.2013 sepse nuk janë përfillur kushtet e parashikuara me nenin 11 të UA në pikën 1, 2.1, 2.2, 2.3, 2.13, duke rekomanduar drejtorisë së shkollës që të përsëriten ftesat për oferta dhe të ndiqen të gjitha procedurat e paraparë sipas UA të lartë cekur. Përveç kësaj anëtar i dytë i Këshillit të shkollës nuk ka asnjë dëshmi se është i caktuar nga kryetari i Këshillit që të përfaqëson Këshillin e shkollës në mungesë të kryetarit sipas pikës 2.13 të nenit 11 të UA. Ditën e nesërme me numrin e referencës 642/13 drejtori i DKA N.Ç ka marrë vendim që të anulohen të gjitha ftesat për ofertë për realizimin e ekskursioneve për shkollat e mesme të Komunës së Prizrenit dhe të shpallen oferta me përputhje me UA me obligim që vendimet e këshillave të shkollave të bëhen publike në lidhje me pikën 2 të nenit 11 UA, të njëjtën ditë i dërgon mesazh drejtorit të shkollës Sh.B me përmbajtje që të mos caktohet data e hapjeve të ofertave pa biseduar paraprakisht me drejtorin e DKA. Në takim me datën 24.09.2013 KDSH ka marrë vendim me të cilën anulohet kërkesa për ofertë e shpallur me 13.09.2013 në gazetën ditore "...", përsëritet oferta duke i parashtruar edhe kushtet e ofertës dhe ekskursioni i maturantëve të realizohet me datën 06.10.2013 në Republikën e Shqipërisë në Shëngjin, me datën e kthimit më 11.10.2013, të njëjtën ditë nga drejtoria e Gjimnazit shpallet përsëritja e ofertës për ekskursionin e maturantëve të shkollës, ku përveç dokumentacionit të nevojshëm për ofertuesit janë shtuar edhe kushtet si rezervimi i hotelit në Shëngjin dhe disa të tjera të cilët nuk janë paraparë me UA 27/13 të datës 18.06.2013 dhe në mënyrë elektronike informon drejtorin e DKA duke i njoftuar se shkolla ka anuluar ofertën dhe ka bërë përsëritjen e ofertës të protokolluar me datën 24.09.2013 dhe ka publikuar në gazetën ditore "..." me datën 25.09.2013. Në bazë të kushteve e veçanta të cilat nuk janë paraparë në UA kanë favorizuar kompaninë "..." dhe me datën 03.10.2013 është shpallur fitues si kompani ofertuese me 90 pika ndaj kompanisë "..." me 61 pika ndërsa "..." është eliminuar si kompani me licencë të skaduar, më dt. 04.10.2013 këto dy kompani të fundit kanë ushtruar ankesa të cilat personalisht ka pranuar i akuzuari B.L, por të njëjtat nuk janë shqyrtuar dhe në fund me datën 06. Tetor 2013 në bazë të vendimit është realizuar ekskursioni i maturantëve.

Këtë gjendje faktike gjykata ka vërtetuar në bazë të mbrojtjes të të akuzuarve dhe provave materiale të administruar gjatë shqyrtimit kryesor dhe dëshmitë e dëshmitarëve .

Gjykata ka analizuar mbrojtjet e të akuzuarve dhe tezat e mbrojtjeve të cilat nuk ka pranuar duke marrë parasysh faktet jo kontestuese se në rastin konkret është bërë përsëritja e ofertës për ekskursion e maturantëve të Shkollës së Mesme të Lartë- Gjimnazi "..." në ... nga ana e drejtorisë së shkollës, e kjo është vërtetuar në bazë të provave materiale edhe atë autorizimit dhe pëlqimit i DKA-së në Prizren me nr. 596/16, vendimit të DKA-së për anulim, qëndrimin të DKA-së nr. 628/13 të datës 23.09.2013, vendimit të DKA-së të datës 24.09.2013 për anulimin e të gjitha ftesave për ofertë , e-mailit të drejtorit të DKA-së të datës 24.09.2013 dhe në bazë të deklaratës së drejtorit të DKA-së të dhënë në Prokurori dhe në gjykatë së bashku me vendimin e drejtorit të DKA-së me nr. 666/13 të datës 01.10.2013 për delegimin e kompetencave; nuk është kontestuese edhe se nga shpallja për përsëritjen e ofertës me nr. 491 të datës 24.09.2013, nga paragrafi "kushtet", nga drejtoria e shkollës- drejtori i shkollës dhe kryetari i Këshillit Drejtues, janë kërkuar edhe kushtet e veçanta të cilat nuk janë të parapara në UA nr.27/13 dhe me vendosjen e këtyre kushteve janë favorizuar kompaninë "...", i cili fakt vërtetohet nga procesverbali i mbledhjes së KD i shkollës të mbajtur me datën 03.10.2013, nga është vërtetuar se "... Trans" është shpallë fituese si kompani ofertuese me 90 pika ndaj kompanisë "..." me 68 pika dhe "..." e cila është eliminuar si kompani me licencë të skaduar; se nga procesverbali i përmendur është vërtetuar se pjesëtarët e komisionit për vërtetimin e rezervimit të hotelit në Shëngjin kanë qenë të akuzuarit B.N dhe Sh.B, të cilët kanë shkuar për të bërë një vërtetim të tillë ndërsa vërtetimin për realizimin e ekskursionit të maturantëve të datës 06 tetor 2013, kanë nënshkruar të akuzuarit B.L dhe B.N; se nga regjistri i nxënësve maturantë i datës 05 tetor 2013, ka rezultuar se i akuzuari Sh.B me datën 05 tetor

2013, si përgjegjës ka nënshkruar këtë dokument edhe pse e ka pezulluar pozitën e tij si drejtor; se gjatë hapjes së ofertave për herë të dytë janë bërë parregullsi në gjimnazin "...", ngase në ofertën e dytë drejtorja e shkollës ka kërkuar kushtet të cilat nuk parashihen me Udhëzimin Administrativ duke e ngarkuar Këshillin Drejtues të shkollës se gjoja ajo ka marrë vendim për kushte shtesë dhe me këtë i ka dhënë favore një operatorit duke mos i bërë të barabartë të gjithë, e po ashtu kjo ofertë ka pasur kufizim në datë, në vendin i cili do të vizitohet dhe kushtet e parapëlqyera e të cilat janë në kundërshtim me UD dhe pëlqimi për shkuarjen në ekskursion sipas kësaj oferte është dhënë kur drejtorit Sh.B zyrtarisht i është pezulluar pozita e drejtorit për shkak të pjesëmarrjes në kampanjën zgjedhore; se DKA nuk ka pranuar asnjë ankesë zyrtarisht nga gjimnazi sepse të gjitha procedurat janë kryer për një kohë të shkurtër para datës së planifikuar për ekskursion dhe raporti i Këshillit të shkollës është dorëzuar përfaqësuesit të kompanisë pas përfundimit të ekskursionit edhe pse kanë pasur për obligim ta dorëzojnë menjëherë pas hapjes së ofertave. Në atë drejtim flet edhe mbrojtja e të pandehurit B.L i cili ka deklaruar se prej datës 03 tetor 2013 ka marrë rolin e ushtruesit të drejtorit ngase drejtorit i është ngrirë pozita për shkak të pjesëmarrjes në fushat elektorale dhe atë ditë ka nënshkruar dokumentin -vendimin rreth përzgjedhjes së ofertës për ekskursionin e maturanëve për vitin 2013. Në mbledhjen e mbajtur në ora 19:00 unanimisht është zgjedhur kompania "...” dhe kështu, për shkak të rrethanave të krijuara ai edhe ka nënshkruar vendimin ngase ekskursioni ishte caktuar për datën 06 tetor 2013, ai nuk ka pasur njohuri që Këshilli i shkollës vendimin përfundimtar duhet të nënshkruante pas shqyrtimit të ankesave eventuale të kompanive jo fituese, prandaj dhe ka nënshkruar vendimin atë ditë. Me datën 04 tetor 2013 rreth orës 18:00 ka pranuar dy zarfe me dokumente nga dy kompani, këto dokumente i ka pranuar dhe i ka nënshkruar, ka qenë i vetëdijshëm se ankesat duhet të pranohen 3 ditë duke llogaritur edhe ditën e punës, por dita e tretë i binte ditë e premtë, të cilën ditë në mëngjes nxënësit tashmë duhej të niseshin për në Shqipëri, pra nuk e ka mbledhur Këshillin Drejtues për vendosje pasi që çdo gjë ishte kryer dhe nxënësit ishin nisur në Shqipëri. Po ashtu edhe të akuzuarit Sh.B dhe B.N kanë deklaruar se gjatë përzgjedhjes së operatorit si kusht ka qenë përzgjedhja e operatorit ekonomikisht më të favorshëm por nuk janë përfillur procedurat e ofertës me rastin e përzgjedhjes së ofertuesit sipas kushteve të kërkuara me ftesën për përsëritjen e ofertës të datës 24.09.2013, për faktin se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontakte nuk figurojnë kriteret e specifikuar të peshuar ma përqindje përkatëse, nuk është përfillur neni 52 par. 2 dhe 3 të LPP. Sipas neni 11 pik. 2.13 UA, përcaktohen kushtet që duhet plotësuar për përzgjedhjen e Agjencisë turistike sipas ofertës , pra të jetë e licencuar, të ketë bërë kontrollin teknik sipas procedurave ligjore dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve, autobusi të jetë komfortë dhe me klimë, të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit, të figurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi që mjeku i shoqëron nxënësit, mirëpo askund në këtë dispozitë ligjore e as në Udhëzimin Administrativ nuk kërkohen kushtet të cilat janë përcaktuar në ri ofertën si kushte të veçanta dhe me këtë janë shkelur të drejtat e personave të tretë, këtu të dëmtuarve. Në ligjin për turizëm 04/L-176 nuk përcaktohet se Agjencia Turistike duhet të ketë licence dhe neni 22 i këtij Ligji shfuqizon Ligjin e mëparshëm për Turizëm dhe Shërbime Turistike. Sipas mendimit të gjykatës të akuzuarit Sh.B dhe B.N kanë tejkualuar autorizimet e veta me vet faktin se gjatë përpilimit të tekstit për përsëritjen e ofertës për ekskursionin e maturanëve të SHML "...” në ..., si drejtor i shkollës, dhe kryetar i KSh të shkollës, vendosin kushtet të cilat i përshtaten ofertuesit të kompanisë turistike "...” edhe pse kanë qenë të obliguar që kushtet ti përcaktojnë në bazë të udhëzimit UA nr. 27/13 dhe Ligjit të Prokurimit Publik, si dhe i tejkalojnë kompetencat të cilat u ka dhanë DKA-ja me qëndrimin nr. 628/13 të datës 23. shtator 2013, ndërsa të pandehurit B.L dhe B.N i tejkalojnë autorizimet e tyre duke nënshkruar vendimin nr. 564 të datës 03.tetor. 2013, pa kaluar afati për shqyrtimin e ankesave, ndërsa i pandehuri B.L nuk i ka përmbushur detyrat e tij sipas autorizimit për procedimin e ankesave më tej në Këshillin Drejtues të kësaj shkolle. Me të

gjitha këto veprime të akuzuarit kanë shkaktuar dëme materiale personave të tretë, pra çdo nxënësi nga 11 € ndërsa të dëmtuarave Agjencive Turistike u kanë shkaktuar dëme material në vlerën e shpenzimeve të bëra. Pranë kësaj gjykata nuk ka marrë parasysh pjesën e mbrojtjes së tyre se gjatë tërë procedurës ata janë udhëhequr nga interesat e nxënësve dhe se koha ka qenë e pamjaftueshme për organizimin e ekskursionit, kjo sepse e gjithë këto nuk arsyetojnë faktin shkeljet të bazës ligjore të UA dhe të dispozitave të tjera ligjore.

Nga të gjitha të cekurat më lartë gjykata ka gjetur se në veprimet të të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën janë shpallë fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimet gjykata ka analizuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimeve. Prej rrethanave rënduese për të gjithë të akuzuarit ka marrë shkallën e përgjegjësisë penale, ndërsa prej rrethanave lehtësuese janë marrë se janë familjarë, sjellje korrekte pranë gjykatës, nuk kanë qenë të dënuar më herët, prandaj duke marrë për bazë nenin 76 të KP-së, konsideron edhe me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi kërkesën pronësore juridike është marrë në bazë të nenit 463 të KPP-së.

Vendimi mbi paushallin gjyqësorë është marrë në bazë të nenit 450 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**Departamenti i Krimeve të Rënda**

**P.nr. 83/2017 me datë 27.10.2017**

**Sekretarja juridike  
Valdete Zurnaxhiu**

**Përkthyesi gjyqësor  
Asnije Berisha**

**Kryetarja e trupit gjykues  
Raima Elezi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – e nëpërmjet të kësaj gjykate.